LEXMARK LEGAL

PO MENDONI TË EMIGRONI NË MB DHE JU DUHEN KËSHILLA TË SIGURTA LIGJORE?

JENI NË VENDIN E DUHUR!

Ekipi ynë i avokatëve të specializuar në emigracion ofron asistencë profesionale për:

- Aplikime për viza
- Vendbanim të përhershëm (ILR)
- Shtetësi britanike
- Çështje azili
- Apelime kundër dëbimit

Ne ju mbështesim me përkushtim dhe transparencë në çdo fazë të procesit.

E ARDHMJA JUAJ NË MB FILLON ME VENDIMIN E DUHUR.

Kontaktoni Lexmark Legal sot – ekspertët që ju qëndrojnë pranë në çdo hap.
Partneri juaj i besueshëm në emigracion.

The Law Society

THAMES VALLEY CHAMBER OF COMMERCE GROUP

Legal awards 2021

- 07494181220
- 07435119343
- 02080902488

Ashley House 235 - 239 High Road, Wood Green, London N22 8HF

www.lexmarklegal.com

The Albanian

VITI I 24 I BOTIMIT 25 GUSHT 2026

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

GJYKATA BRITANIKE FRENON DËBIMET DREJT SHQIPËRISË: VIKTIMAT E TRAFIKIMIT PËRBALLEN ME RREZIK REAL NËSE KTHEHEN

PETRIT KUÇANA

RAMA-FARAGE DHE INVESTIMET E MUNGUARA BRITANIKE

URAN FERIZI

STUDIMI I AMBASADËS SHQIPTARE NË LONDËR GJATË PERIUDHËS 2018–2025 MË SHUMË SE 70,000 APLIKIME PËR VIZA ANGLEZE NGA SHTETAS SHQIPTARË U REFUZUAN

PATER HAPPEL

SANDER LLESHAJ

DYQANET QË NA JEPNIN FALË AROMËN

DAUT DAUTI

PRESHEVA NUK MUND TË KETË DY STANDARDE

ARDITA SINANI

GUXIMI I PASKRUPULLT PËR PROPAGANDË

LUTFI DERVISHI

PËRGJIGJE AMBASADORIT NEBOJSHA VUJOVIQ: NJË SERBI QË ËSHTË NË PAQE ME VETE E ME FQINJËT

VETON SURROI

Rashid A.Khan Solicitor (Principal)Mob: 07774222062 190 MERTON HIGH STREET WIMBLEDON , LONDON SW19 1AX

RASHID and RASHID LAW FIRM

RASHID & RASHID

Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

The Albanian newspaper in London
THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk
albania7@gmail.com
Tel: 020 7018 7929

RAMA-FARAGE DHE INVESTIMET E MUNGUARA BRITANIKE



PETRIT KUÇANA

Farage nuk shkoi në Tiranë. Akoma…
Të paktën ky mund të konsiderohet si një lajm goxha i mirë, sidomos për shqiptarët e Britanisë.
Janë pikërisht shqiptarët e Britanisë që e përjetuan atë trishtim, krejtësisht të pameritуar, që erdhi si 'tekë' e kryeministrit Rama, për të gjykuar një vendim referendar të qytetarëve britanikë. Kjo u shfrytëzua 'për merak' nga Farage dhe e gjitha që mbeti, mbase për qytetarët britanikë, nuk i kalon caqet e imazhit 'më së paku' të dërrmuar të shqiptarëve të Britanisë, që 1 në 50 shqiptarë janë të burgosur.
Më kot të pyesësh se çfarë i duhet kryeministrit Rama që të komentojë një gjë të tillë? Krejtësisht retorike duket çdo lloj pyetje, madje-madje në Tiranë e shohin si 'fun', si një gati-gati meritë të Ramës, që 'ua theu brinjtë britanikëve'.
Edhe gjatë vizitës së fundit në Londër në 'Procesin e Berlinit', Rama i mëshoi pikërisht kësaj retorike, ndërkohë që as që nuk e çoi ndërmend të prishë traditën kryeministrore që të bëjë një takim me diasporën e këtushme, siç bëri bie fjala kryeministri Kurti.
Po sikur Rama të harronte këtë retorikë dhe të shikonte nënshkrimin e ndonjë marrëveshje me ndonjë kompani Britanike, sic bëri kryeministri maqedonas?
Imagjinoni sikur Rama të nënshkruante marrëveshje me kompani amerikano-britanike dhe të punësonte të paktën 1000 shqiptarë?
Imagjinoni një moment, që ai investim të kryhej në qarkun më të varfër të republikës, në qarkun e Kukësit.
Së paku do të kishte 1000 më pak të larguar? Së paku do të kishte me çfarë të mburrej, ashtu siç bëri atëherë me



Aeroportin e Kukësit.
Me patjetër që shumëkujt i kujtohet por që krejtësisht në heshtje çdokush pyet se çfarë u bë me aeroportin e Kukësit?
Asnjë përgjigje nuk mund të marrin, e deri më sot nuk ka qoftë edhe një përgjigje të qartë se çfarë u bë, si ndodhi, pse?
Thuhet që është kthyer në fushë garash për makina?
Sa vende pune humbën?
E nëse media do të ishte e lirë që të investigonte, kushedi sa skandale do të plasnin, e me patjetër kryeministri Rama 'do të sqaronte fije e për pe' ku çedoi me aeroportin dhe thjeshtësist t'i përgjigjej pyetjes se edhe për sa kohë do të qëndrojë i mbyllur aeroporti i Kukësit?
Mbase është e paimagjinueshme për Ramën që të takojë diaspoën (jo vetëm atë në Britani) sepse mjaftohet me ca fjali 'karagjoze' që 'këputi në mes britanikët' dhe ja ku u kry misioni i tij.
Jo! Që kur është zgjedhur kryeministri Rama nuk ka takuar shqiptarët e Britanisë.
Duhet theksuar se fjalimi i parafushatës elektorale, nuk mund të konsiderohet takim, thjesht fjalim.
Mbase Rama përpara se të merret me Farage do të ishte mirë tu jepte llogari shqiptarëve se çfarë po bëhet me premtimin e tij 'për të stabilizuar' shqiptarët e Brtianisë, për t'i kthyer ata në identitet?
Apo as për këtë çështje nuk ka çfarë të thotë.
Mbase shumëkujti i kujtohet vizita disaorëshe e Lordit Cameron në Tiranë, ku shprehu gadishmërinë e Britanisë së Madhe për t'u angazhuar në hekurudhën që lidh Kosovën me Shqipërinë.

Që nga ajo kohë nuk është dëgjuar më asgjë? U tërhoqën britnikët? Pse-të dalin të shumta. E nëse shohim se çfarë është bërë me aeroportin e Vlorës, kushedi sa përgjigje vijnë të gatshme gati-gati turpëruese. E ndërsa Rama pret Radhën për t'iu thënë edhe ca fjali Farage…për ta këputur brinjë me brinjë… ***Ribotim***

LEXMARK
LEGAL

DËSHIRONI TË JETONI, PUNONI APO STUDIONI NË MB?

Ne ofrojmë shërbime të specializuara imigrimi, të përshtatura sipas rrethanave tuaja.

Ekipi ynë profesionist ju udhëzon në çdo hap, duke e bërë procesin e imigrimit të qartë, të sigurt dhe pa stres.

SHËRBIMET TONA PËRFSHIJNË:

- Viza për punëtorë të kualifikuar
- Viza studimi
- Viza për bashkëshort dhe familjarë
- Viza Global Talent & Inovative
- Punonjës fetarë
- Vendbanim të përhershëm (ILR)
- Shtetësi britanike
- Apelime dhe rishikime vizash

Ne ju ndihmojmë me këshillim profesional, përgatitje dokumentesh dhe mbështetje të plotë gjatë aplikimit.

Na kontaktoni sot për një të ardhme më të sigurt në Mbretërinë e Bashkuar.
Ekspertë të besuar të imigracionit.

- 07494181220
- 07435119343
- 02080902488

Ashley House 235 - 239
High Road, Wood Green,
London N22 8HF

GJYKATA BRITANIKE FRENON DËBIMET DREJT SHQIPËRISË: VIKTIMAT E TRAFIKIMIT PËRBALLEN ME RREZIK REAL NËSE KTHEHEN

Vendimi pritet të jetë goditje e madhe për qeverinë, e cila po përpiqet të rrisë numrin e personave që dëbon nga vendi.

Shqiptarët kryesojnë shifrat e personave të larguar me forcë nga Mbretëria e Bashkuar gjatë pesë viteve të fundit.

Ministria e Brendshme britanike mund të pengohet të deportojë shumë djem të rinj, viktima të trafikimit, drejt Shqipërisë, pas një vendimi të fundit gjyqësor. Sipas The Guardian, mijëra djem shqiptarë janë identifikuar si viktima të mundshme të trafikimit në Mbretërinë e Bashkuar gjatë viteve të fundit. Shumë prej tyre dërgohen përsëri në vendin e tyre, pasi Ministria e Brendshme argumenton se ata do të jenë të sigurt në Shqipëri.

Vendimi pritet të jetë goditje e madhe për qeverinë, e cila po përpiqet të rrisë numrin e personave që dëbon nga vendi.
Shqiptarët kryesojnë shifrat e personave të larguar me forcë nga Mbretëria e Bashkuar gjatë pesë viteve të fundit. Sipas shifrave të qeverisë britanike, 2,247 shqiptarë u deportuan në 12 muajt deri në fund të marsit, duke përbërë një të katërtën e kthimeve të detyruara.

Të rinjtë shqiptarë, viktimat kryesore të trafikimit

Më parë, shumica e viktimave shqiptare të trafikimit ishin gra që dërgoheshin në Mbretërinë e Bashkuar për të punuar në industrinë e seksit.

Ndërsa, sot viktimat janë më shumë meshkuj të rinj, të cilët trafikohen për të punuar në tregtinë e drogës, si shpërndarës ose si "kopshtarë" në fermat e kanabisit.

Në vitin 2022, 4,107 meshkuj shqiptarë iu referuan shërbimeve britanike për shkak të dyshimeve për trafikim, krahasuar me 502 gra. Në vitin 2023, shifra ishte 3,463 meshkuj dhe 588 femra.

Rrezik real nëse kthehen në Shqipëri

Gjithçka nisi nga një 21-vjeçar, viktimë e trafikimit nga Shqipëria, i cili u shfrytëzua për herë të parë nga një bandë shqiptare në Belgjikë, kur vizitoi vendin së bashku me babanë e tij në moshën 16-vjeçare.

Ai iu shit një bande tjetër shqiptare, e cila e solli në Mbretërinë e Bashkuar dhe e detyroi të punonte në kultivimin e bimëve të kanabisit. Më vonë ai u arratis dhe u njoh si viktimë e trafikimit, por iu refuzua azili, pasi iu tha se do të ishte i sigurt nëse kthehej në Shqipëri.

Një trup gjykues prej tre gjyqtarësh të lartë në Tribunalin e Lartë të emigracionit pranoi kërkesën e tij për azil dhe konstatoi se, edhe pse kishin kaluar pesë vjet që nga koha kur ai ishte trafikuar për herë të parë, ai vazhdonte të ishte në rrezik real nga trafikantët e tij dhe nuk mund të kthehej në mënyrë të sigurt në Shqipëri.

Udhëzim i ri për Home Office

Gjyqtarët nxorën udhëzime të reja për Britaninë, të cilat qeveria duhet t'i marrë në konsideratë dhe Ministria e Brendshme duhet t'i zbatojë përpara se të vendosë nëse do t'i kthejë në Shqipëri djemtë që janë viktima të trafikimit. Vendimi konstatoi se, megjithëse Shqipëria ka bërë përparim në luftën kundër korrupsionit, ai vazhdon të jetë një problem i përhapur.

Gjykata gjithashtu vuri në dukje se nuk ka streha të posaçme për viktimat e trafikimit dhe se rreziku që të ritrafikohen pas kthimit në Shqipëri është i konsiderueshëm. Qendra Ligjore e Islingtonit e cila ka ekspertizë të veçantë në përfaqësimin e viktimave shqiptare të trafikimit, vuri në dukje një sërë praktikash shqetësuese që bandat përdorin ndaj viktimave të tyre.

Këto përfshijnë filmimin e qëllimshëm të abuzimit seksual, përfshirë përdhunimin e fëmijëve viktima të trafikimit, dhe kërcënimin për publikimin e pamjeve në rrjetet sociale.

Atyre gjithashtu u shfaqin të rinjve video të njerëzve të tyre të dashur në Shqipëri, për tu bërë të ditur se e dinë se kush janë familjarët e tyre. Ndërsa bandat u shkaktojnë fëmijëve dhe të rinjve edhe dëmtime fizike, si thyerje të kockave.

Burime nga Ministria e Brendshme thanë se po shqyrtojnë nëse do të kërkojnë leje për apelimin e vendimit.

Dotech
Websites

SHQIPTARË NË BRITANI

BIZNESI JUAJ MERITON NJË

WEBSITE
QË SJELL REZULTATE

👉 A keni një biznes në MB por ende nuk keni një faqe interneti profesionale?

Dotech Websites ju ndihmon të krijoni një faqe moderne që sjell më shumë klientë dhe rrit besueshmërinë e biznesit tuaj.

- **Website** profesional dhe modern
- I përshtatur për telefon, tablet dhe kompjuter
- Optimizim për Google (SEO)
- Shpejtësi dhe siguri maksimale
- **Dyqan online** (E-commerce)
- Email profesional me emrin e biznesit tuaj
- Mbështetje teknike në gjuhën shqipe

ME SHUMË KLIENTË	ME SHUMË REZULTATE	ME SHUMË BESUESHMËRI	MBËSHTETJE NË SHQIP

NA KONTAKTONI SOT PËR NJË
KONSULTIM FALAS!

020 7018 7929
Whatsup: 073 4066 5946
Whatsup: 078 5997 7545

ADRESA E ZYRAVE:
30 Avenons Road,
London, E13 8HT

WEB:
www.dotech.uk

EMAIL:
info@dotech.uk

DOTECH WEBSITES
Website profesionale për bizneset shqiptare në Britani.

WEB DESIGN | WEB DEVELOPMENT | SEO OPTIMIZATION | E-COMMERCE SOLUTIONS | SUPPORT & MAINTENANCE

#ShqiptaretNeBritani #BiznesShqiptar #WebsiteProfesional #WebDesignUK #Dotech #SEO #BiznesNeAngli
#MarketingDigital #London #Manchester #Birmingham #AlbaniansUK #KosovareNeBritani #shqipet
#shqipetnelonder #shqipetneuk #shqipetneangli #webdesign #webdesignservices #webdesignanddevelopment
#WebDesignAndDevelopmentServices #WebDesignandDevelopmentAgency

VENDIMI I GJYKATËS BRITANIKE MUND TË FRENOJË DEPORTIMIN E VIKTIMAVE SHQIPTARE TË TRAFIKIMIT

Një vendim i fundit i drejtësisë britanike mund të ndryshojë mënyrën se si autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar trajtojnë rastet e shqiptarëve të identifikuar si viktima të trafikimit. Gjykata ka paralajmëruar se kthimi i disa prej tyre në Shqipëri mund t'i ekspozojë ndaj rrezikut të dhunës, ri-trafikimit dhe shfrytëzimit nga rrjetet kriminale.

Shqiptarët janë ndër kombësitë më të prekura nga dëbimet në Britani gjatë viteve të fundit. Në të njëjtën kohë, të dhënat tregojnë një rritje të fortë të numrit të meshkujve shqiptarë të identifikuar si viktima trafikimi.

Në vitin 2022, rreth 4,017 meshkuj shqiptarë iu referuan shërbimeve britanike për dyshime mbi trafikimin, krahas 502 femrave. Një vit më vonë, u regjistruan 3,463 meshkuj dhe 588 femra.

Ndryshimi i profilit të viktimave është një nga elementet që ka marrë vëmendje në këtë çështje. Në të kaluarën, viktimat shqiptare ishin kryesisht gra të trafikuara për shfrytëzim seksual. Sot, një pjesë e konsiderueshme e rasteve lidhet me djem dhe të rinj që detyrohen të punojnë në trafikun e drogës apo në kultivimin e kanabisit.

Rasti që mbërriti në gjykatë

Çështja u ngrit nga një 21-vjeçar shqiptar, i cili ishte trafikuar që në moshën 16-vjeçare. I riu kishte udhëtuar drejt Belgjikës me të atin, ku përfundoi nën kontrollin e një grupi kriminal shqiptar. Më pas, ai iu shit një tjetër rrjeti, i cili e çoi në Britani dhe e detyroi të punonte në kultivimin e kanabisit.

Pas arratisjes, i riu u njoh zyrtarisht nga autoritetet britanike si viktimë e trafikimit.

Rasti i tij ka shtyrë gjykatën të vendosë udhëzime të reja mbi mënyrën se si duhet vlerësuar situata në Shqipëri përpara se Home Office të marrë vendime për kthimin e viktimave meshkuj.

Shqetësimi kryesor: ri-trafikimi

Në vlerësimin e saj, gjykata ka evidentuar disa probleme që mund ta bëjnë kthimin e viktimave veçanërisht të rrezikshëm. Mes tyre përmendet mungesa e strehimoreve të posaçme për burrat e rritur që kanë qenë viktima të trafikimit.

Gjykata ka ngritur gjithashtu shqetësimin se personat e trafikuar mund të bien sërish në duart e rrjeteve kriminale pas kthimit në Shqipëri. Edhe pse vendi ka bërë përparim në luftën kundër korrupsionit, gjykata vlerëson se ky fenomen mbetet i përhapur.

Për disa prej viktimave, kërcënimi nuk përfundon me arratisjen nga trafikantët. Organizatat që trajtojnë këto raste kanë raportuar përdorimin e dhunës fizike, kërcënimeve dhe shantazhit për të ruajtur kontrollin mbi të rinjtë.

Në rastet e të miturve, trafikantët thuhet se kanë përdorur edhe video të abuzimit seksual si mjet kërcënimi, duke paralajmëruar publikimin e tyre në rrjetet sociale. Në raste të tjera, viktimave u janë treguar video ose materiale që lidhen me familjarët e tyre në Shqipëri, për t'u bërë të qartë se trafikantët dinë ku ndodhen dhe kush janë të afërmit e tyre.

Raportohen gjithashtu raste të dhunës së rëndë fizike ndaj të miturve dhe të rinjve, përfshirë dëmtime serioze dhe thyerje kockash.

Vendimi i gjykatës nuk nënkupton ndalimin automatik të deportimeve, por vendos një standard të ri vlerësimi për rastet e viktimave meshkuj të trafikimit. Për Home Office, çdo vendim për kthimin e tyre duhet të marrë parasysh jo vetëm statusin e viktimës, por edhe rrezikun konkret që mund ta presë atë pas kthimit në Shqipëri.

STUDIMI I AMBASADËS SHQIPTARE NË LONDËR GJATË PERIUDHËS 2018–2025, MË SHUMË SE 70,000 APLIKIME PËR VIZA ANGLEZE NGA SHTETAS SHQIPTARË U REFUZUAN

Shqipëria është vendi me numrin më të lartë të refuzimit të vizave britanike krahasuar me të gjitha vendet e Ballkanit perëndimor.

Një studim i udhëhequr nga Uran Ferizi ambasador i Shqipërisë në Londër, bazuar në të dhënat ë Home Office tregon gjatë periudhës 2018–2025, më shumë se 70,000 aplikime për viza nga shtetas shqiptarë u refuzuan, ndërsa norma e miratimit për Shqipërinë mbeti dukshëm nën mesataren rajonale.

Ky grafik tregon se niveli dhënies së vizave për shtetasit nga Serbia ishte 94.7%, ata nga Mali i Zi 92.9%, nga Bosnje Hervegovina 93.0%, nga Maqedonia e Veriut 91.5%, Kosova 74.4% dhe Shqipëria në vend të fundit me një miratim vizash prej 65.5%.



Sipas këtij studimi "qasja e kufizuar në rrugët e ligjshme, kostot më të larta të aplikimit dhe perceptimi se rrugët e rregullta ishin praktikisht të mbyllura mund të kenë qenë pjesë e mjedisit më të gjerë në të cilin disa migrantë potencialë iu drejtuan rrugëve të parregullta", raporton gazetari i Top Channel Muhamed Veliu.

Studimi përfshin edhe aspektet e emigracionit ilegal të shqiptarëve drejt shtetit ishull. Rritja e migrimit shqiptar në vitin 2022 ishte reale, por jetëshkurtër thuhet në studim.

Mbërritjet e shqiptarëve me varka të vogla dhe kërkesat për azil u rritën jashtëzakonisht shumë në vitin 2022, por më pas ranë me shpejtësi.

Deri në vitin 2025, kërkesat shqiptare për azil ishin rikthyer pranë niveleve të para pandemisë dhe Shqipëria nuk ishte më ndër kombësitë kryesore që kalonin Kanalin Anglez.

Duke komentuar këtë studim për gazetën The Guardian ambasadori Uran Ferizi deklaroi se "numri i shqiptarëve që udhëtuan drejt Britanisë me varka të vogla katër vite më parë mbetet në qendër të kritikave "të pabazuara" dhe "histerike" nga politikanët e krahut të djathtë dhe media, sipas ambasadorit të Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar".

Ai i bëri thirrje partisë së Nigel Farage që të ndalojë "etiketimin e shqiptarëve" dhe tha se politika britanike e vizave në atë kohë, e cila miratonte një përqindje më të ulët vizash për shqiptarët sesa për njerëzit nga vendet e tjera të Ballkanit, mund të ketë shtyrë disa shqiptarë vulnerabël drejt trafikantëve.

"Një pakicë e zhurmshme në politikën dhe median britanike e ka mbajtur gjallë krizën e migracionit shqiptar shumë kohë pasi ajo përfundoi në të dhënat," shtoi ai.

"Partisë Reform UK do t'i bënte më shumë shërbim Britanisë duke u marrë me papunësinë e të rinjve dhe mirëqenien sociale, sesa duke u marrë me 'etiketimin e shqiptarëve'." ka deklaruar për The Guardian ambasadori Uran Ferizi.

Top Channel

SKANDAL SIGURIE NË LONDËR/ KRYEMINISTRI BURNHAM SHKËMBEN MESAZHE ME PERSONIN QË HIQEJ SI NDIHMËSI I TRUMP

Kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar, Andy Burnham, ka shkëmbyer mesazhe me një person që paraqitej si Susie Wiles, shefja e stafit të Presidentit amerikan Donald Trump, por më vonë dyshohet se ishte një imitues.

Lajmi është raportuar ekskluzivisht nga POLITICO, duke cituar katër zyrtarë të njohur me çështjen. Sipas tyre, Burnham besonte se po komunikonte me Wiles përpara se të lindnin dyshime se kontakti nuk ishte real.

Downing Street nuk pranoi të komentojë konkretisht incidentin, duke deklaruar se nuk diskuton çështjet e sigurisë kombëtare.

Një person i informuar për komunikimet tha se janë shkëmbyer "disa mesazhe" pasi Burnham mori detyrën si kryeministër, por këmbënguli se ato nuk përmbanin informacione të rëndësishme.

Incidenti u konsiderua aq shqetësues sa Ambasada britanike në Uashington e ngriti çështjen me Shtëpinë e Bardhë, sipas dy zyrtarëve të cituar nga POLITICO. Brenda qeverisë britanike u ngritën dyshime se telefoni i Susie Wiles mund të ishte hakuar sërish. Shtëpia e Bardhë nuk ka komentuar mbi rastin.

Rasti rikthen në vëmendje një incident të ngjashëm të vitit të kaluar, kur autoritetet amerikane nisën një hetim pasi

senatorë, guvernatorë dhe drejtues biznesesh morën mesazhe dhe telefonata nga një person që pretendonte se ishte shefi i stafit të Trump.

Sipas raportimeve të mëparshme, Wiles u kishte thënë bashkëpunëtorëve se kontaktet e saj në telefon ishin hakuar.

Nuk dihet ende se çfarë është diskutuar konkretisht në komunikimet mes Burnham dhe personit që imitonte Wiles, apo sa gjatë ka zgjatur kontakti.

Burnham mori detyrën si kryeministër më 20 korrik 2026, pasi kishte fituar zgjedhjet e pjesshme në Makerfield më 18 qershor.

Mbi 500 mijë paund në ditë për ndalimin dhe transferimin e emigrantëve në Britani

Më shumë se 500 mijë paund në ditë shpenzohen nga autoritetet britanike për ndalimin, akomodimin dhe transferimin e emigrantëve në kuadër të sistemit të kontrollit të emigracionit, sipas të dhënave të publikuara nga The Sun.

Sipas shifrave të Home Office, gjatë periudhës qershor 2025 – maj 2026, janë shpenzuar gjithsej £185.5 milionë për transportimin dhe strehimin e personave nën ndalim emigracioni dhe në kujdesin e Border Force, në Britani dhe jashtë saj.
Pjesa më e madhe e kësaj shume, rreth £137.1 milionë, është përdorur për shoqërimin dhe transferimin e emigrantëve brenda Mbretërisë së Bashkuar. Kjo përfshin lëvizjet ndërmjet burgjeve, komisarateve të policisë, spitaleve dhe qendrave të përkohshme të mbajtjes.

Rreth £48.5 milionë të tjera janë shpenzuar për shoqërimin e emigrantëve gjatë kthimit të tyre në vendet e origjinës, përmes fluturimeve të rregullta ose charter.

Shpenzimet kanë shkaktuar reagime të forta politike. John O'Connell nga Tax-Payers' Alliance i ka cilësuar ato si një "shpërdorim marramendës" të parave publike, ndërsa sekretari hije i Brendshëm, Chris Philp, i ka përshkruar si një "shpërdorim katastrofik të parave të taksapaguesve".
Nga ana tjetër, Home Office ka sqaruar se shifrat nuk përfshijnë vetëm transportin, por edhe qendrat e ndalimit të emigracionit dhe shërbime të tjera operacionale.
Në total, shpenzimi prej £185.5 milionë në një vit përkthehet në afërsisht £508 mijë në ditë, duke e kthyer koston e sistemit të ndalimit dhe transferimit të emigrantëve në një tjetër pikë debati mbi përdorimin e parave të taksapaguesve në Britani.

AMBASADORI SHQIPTAR NË LONDËR KRITIKON ASHPËR TË DJATHTËN BRITANIKE

VITJON NINA

Ambasadori i Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, Uran Ferizi, ka kritikuar ashpër politikanët dhe mediat e krahut të djathtë në Britani për atë që e cilëson si një "fiksim të pakuptimtë dhe histerik" me emigracionin shqiptar të vitit 2022.

Në një intervistë për The Guardian, Ferizi tha se fluksi i mbi 12 mijë shqiptarëve që kaluan Kanalin Anglez me gomone në vitin 2022 ishte real, por një fenomen "i jashtëzakonshëm dhe jetëshkurtër", ndërsa sot Shqipëria dhe komuniteti shqiptar në Britani vazhdojnë të stigmatizohen për shkak të asaj periudhe.

Sipas një raporti 10-faqësh të përgatitur nga Ambasada shqiptare, bazuar kryesisht në të dhënat e Home Office dhe Migration Observatory të Universitetit të Oxfordit, të cilin Albanian Post e ka publikuar në detaje, 12 mijë e 658 shqiptarë kaluan Kanalin në vitin 2022. Kjo shifër përbënte rreth 1% të emigracionit afatgjatë në Britani gjatë atij viti.

Ambasada argumenton se numri i mbërritjeve ra ndjeshëm pas vitit 2022 dhe se shumica e personave të asaj vale migratore tashmë janë larguar nga Britania.

"Ndaloni gjuetinë ndaj shqiptarëve"
Ferizi kritikoi veçanërisht Reform UK dhe disa media britanike, duke u bërë thirrje të ndalojnë atë që ai e quajti "Albanian-spotting", pra fokusimin e vazhdueshëm te shqiptarët në debatin për emigracionin.

"Një pakicë e zhurmshme në politikën dhe median britanike e ka mbajtur gjallë krizën e emigracionit shqiptar shumë kohë pasi ajo ka përfunduar në të dhënat reale", deklaroi ambasadori.

Ai shtoi se ky diskurs po ndikon edhe te partitë e tjera politike, të cilat, sipas tij, po përpiqen të konkurrojnë me titujt e Reform UK në vend që të analizojnë të dhënat.

Kritika edhe për politikën e vizave
Një tjetër pikë e ngritur nga ambasadori është politika britanike e vizave.

Sipas raportit të Ambasadës, gjatë viteve 2018-2025 vetëm 65.5% e aplikimeve shqiptare për viza britanike u miratuan, ndërsa për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor norma ishte rreth 90%. Mbi 70 mijë aplikime shqiptare janë refuzuar gjatë kësaj periudhe.

Ferizi argumenton se vështirësia e madhe për të përdorur rrugët ligjore të udhëtimit mund t'i ketë bërë disa të rinj shqiptarë më të ekspozuar ndaj trafikantëve dhe kontrabandistëve.

Ai theksoi se raporti nuk pretendon se refuzimet e vizave shkaktuan drejtpërdrejt fluksin e vitit 2022, por ngre si mundësi faktin që kufizimi i rrugëve ligjore mund të ketë ndikuar në rritjen e vulnerabilitetit ndaj rrjeteve të trafikimit.

"2022 ka mbaruar"
Ambasadori shqiptar, i cili vetë ka një histori të veçantë me Britaninë - pasi mbërriti atje në adoleshencë si pasagjer i fshehtë dhe vite më vonë studioi matematikë në Universitetin e Oxfordit - tha se debati britanik duhet të shkëputet nga ngjarjet e vitit 2022.

"Fluksi ishte real. Por ishte i jashtëzakonshëm, jetëshkurtër dhe Britania vazhdon të flasë për shqiptarët sikur viti 2022 të mos kishte përfunduar", u shpreh Ferizi.

Ai ka kritikuar gjithashtu mënyrën se si disa media britanike kanë paraqitur komunitetin shqiptar, duke argumentuar se krahasimet mbi kriminalitetin duhet të marrin parasysh faktorë si mosha dhe gjinia e popullsisë.

Reform UK dhe The Daily Telegraph janë kontaktuar nga The Guardian për një reagim lidhur me deklaratat e ambasadorit, por ende nuk ka një përgjigje zyrtare prej tyre. albanian post

NË TETOR NIS SKEMA E RE: KRIMINELËT E RREZIKSHËM DO TË KUFIZOHEN NË ZONA TË PËRCAKTUARA PAS LIRIMIT NGA BURGU

Një skemë e re që do t'u lejojë autoriteteve të kufizojnë lëvizjet e autorëve të krimeve të rënda seksuale dhe të dhunshme pas lirimit nga burgu do të nisë në muajin tetor.

Sipas planit të qeverisë britanike, personat që lirohen nga burgu dhe që janë nën mbikëqyrje do të mund të kufizohen në zona vetëm disa milje të gjera, në varësi të rrezikut që paraqesin.

Zyrtarët e shërbimit të provës do të përcaktojnë kufijtë për secilin të dënuar, në plane të hartuara edhe në konsultim me viktimat. Nëse një autor i dënuar del jashtë zonës së përcaktuar, ai mund të rikthehet në burg.

Skema shkon përtej "zonave të përjashtimit" që përdoren aktualisht dhe që ndalojnë autorët të afrohen në vende specifike, si shtëpia apo vendi i punës së viktimës.

Sekretari i Drejtësisë, Alex Norris, tha se sistemi do të përdorë edhe GPS, duke mundësuar që shkeljet e kufizimeve të identifikohen shpejt.

Qeveria thotë se masa synon t'u japë viktimave më shumë liri dhe siguri, duke ulur mundësinë e kontakteve të padëshiruara me autorët e krimeve.

Megjithatë, konservatorët kanë kërkuar masa edhe më të ashpra ndaj lirimit të parakohshëm të të dënuarve, ndërsa organizatat që mbështesin viktimat kanë

paralajmëruar se zbatimi efektiv i skemës do të jetë thelbësor për të rikthyer besimin te autoritetet.

The Sun/ Artikull për shqiptarët në burgjet britanike, skema e deportimit dështon: Vetëm 13 të burgosur janë kthyer

Vetëm 13 të burgosur shqiptarë janë transferuar deri tani nga burgjet britanike drejt Shqipërisë, pavarësisht një programi prej 8 milionë paundësh që synonte kthimin e rreth 200 të dënuarve për krime të rënda.

Programi u lançua tre vite më parë me synimin që vrasësit, përdhunuesit dhe trafikantët e drogës të vuanin dënimin në vendin e tyre dhe njëkohësisht të ulej kostoja për taksapaguesit britanikë.

Shqiptarët kanë qenë kombësia e huaj më e përfaqësuar në burgjet britanike gjatë shtatë viteve të fundit. Sipas të dhënave të cituara nga The Sun, rreth 940 shqiptarë ndodhen në burgjet britanike, duke përbërë afërsisht 9-12% të të dënuarve me shtetësi jo-britanike.

Marrëveshja mes Britanisë dhe Shqipërisë për transferimin e të burgosurve u njoftua në vitin 2023 dhe ishte parashikuar të kushtonte 8 milionë paund gjatë dy viteve të para.

Por një burim nga Ministria e Drejtësisë në Shqipëri tha se objektivi ishte transferimi i 200 të burgosurve shqiptarë që vuanin dënime mbi katër vjet, ndërsa deri tani janë transferuar vetëm 13.

Mes të burgosurve që ende ndodhen në Britani janë edhe 15 persona të dënuar për vrasje me burgim të përjetshëm.

Një prej tyre është Koci Selamaj, 41 vjeç, i dënuar me të paktën 36 vite burg për vrasjen e mësueses Sabina Nessa, 28 vjeç, në një park në juglindje të Londrës në vitin 2021.

Marrëveshja synonte të lehtësonte mbipopullimin e burgjeve britanike dhe të ulte kostot, por ritmi i ulët i transferimeve ka ngritur pikëpyetje mbi efektivitetin e programit.

SHQIPTARË NË BRITANI

Dotech websites

BIZNESI JUAJ MERITON NJË WEBSITE QË SJELL REZULTATTE

A keni një biznes në MB por enda nuk keni një **faqe interneti profesionale?**

Dotech Websites ju ndihmon të krijoni një faqe moderne që sjell më shumë klientë dhe rrit besueshmërinë e biznesit tuaj.

- Website profesional dhe modern
- I përshtatur për telefon, tablet dhe kompjuter
- Optimizim për Google (SEO)
- Shpejtësi dhe siguri maksimale
- Dyqan online (E-commerce)
- Email profesional me emrin e biznesit tuaj
- Mbështetje teknike në gjuhën shqipe

NA KONTAKTONI SOT PËR NJË KONSULTIM FALAS!

020 7018 7929
Whatsup: 073 4066 5946
Whatsup: 078 5997 7545

ADRESA E ZYRAVE:
30 Avenons Road,
London, E13 8HT

WEBSITE
www.dotech.uk

EMAIL
info@dotech.uk

DOTECH WEBSITES
Website profesionale për bizneset shqiptare në Britani.

Suksesi juaj fillon online!

MË SHUMË KLIENTË | MË SHUMË BESUESHMËRI | MË SHUMË REZULTATE

KOSTOT "E ÇMENDURA" TË JETESËS, MBI 81 MIJË STUDENTË NË BRITANI ZGJEDHIN TË JETOJNË ME PRINDËRIT

Më shumë studentë të rinj në Britani po zgjedhin të jetojnë në shtëpi me familjen gjatë universitetit këtë vit, më shumë se në çdo moment tjetër në nëntë vitet e fundit.

Të dhënat e UCAS tregojnë se mbi 81 mijë 18-vjeçarë që janë pranuar në universitet kanë deklaruar se do të jetojnë në shtëpi, pra pak më shumë se një në tre studentë të kësaj grupmoshe. Në vitin 2017, kjo shifër ishte rreth një në pesë.

Trendi është i dukshëm në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar. Në Skoci, rreth 48% e aplikantëve planifikojnë të jetojnë në shtëpi, ndërsa në Uells kjo shifër është rreth 20%.

Kostoja e lartë e jetesës dhe veçanërisht çmimet e qirave janë ndër arsyet kryesore që po i shtyjnë studentët të heqin dorë nga akomodimi pranë universitetit.

Beatrice dhe Amelia, dy shoqe nga St Helens, do të nisin universitetin në shtator, por të dyja do të vazhdojnë të jetojnë me familjet e tyre. Beatrice do të studiojë matematikë në Universitetin e Mançesterit dhe do të udhëtojë me tren, ndërsa Amelia do të ndjekë studimet në Liverpool John Moores University.

Amelia tregon se akomodimi që kishte gjetur kushtonte 300 deri në 400 paund në javë.

Për Jessica-n, e cila gjithashtu do të studiojë në Liverpool John Moores University, vendimi është më i dhimbshëm. Ajo thotë se do të kishte dashur të jetonte në kampus dhe të përjetonte jetën studentore, por çmimet e qirave janë bërë "qesharake" dhe "të çmendura".

"Kam një punë me kohë të pjesshme, sepse gjithçka është kaq e shtrenjtë, ndërsa udhëtimi do të më marrë shumë nga koha e lirë", shprehet ajo.

Sipas Higher Education Policy Institute (Hepi), një studenti i duhen rreth 61 mijë paund gjatë një diplome trevjeçare për të pasur një standard minimalisht të pranueshëm jetese, pa përfshirë tarifat universitare.

Në vitin 2024, qiratë për akomodimet universitare varionin nga 108 paund në javë në Irlandën e Veriut deri në 338 paund në javë në Londër. Në shumicën e zonave, çmimet ishin mes 140 dhe 180 paund në javë.

Ndërkohë, shumë studentë përfitojnë kredi për mirëmbajtje, por rritja e kostove të akomodimit ka qenë më e shpejtë se rritja e kësaj ndihme financiare. Si pasojë, shumica e studentëve të rinj me kohë të plotë tashmë punojnë gjatë semestrit për të përballuar diferencën mes të ardhurave nga kredia dhe kostos së jetesës.

GATI 32% TË SHQIPTARËVE NË PASIGURI USHQIMORE, KATËR HERË MBI MESATAREN EUROPIANE

Rreth 31.8% e shqiptarëve përballen me pasiguri ushqimore të moderuar ose të rëndë në periudhën 2023-2025, vlerëson FAO. Ndonëse treguesi ka shënuar përmirësim të lehtë, ai mbetet shumë më i lartë në Europë dhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO).



Në harkun e një viti, treguesi është ulur me 1.2 pikë përqindjeje. Pavarësisht përmirësimit, niveli në Shqipëri është rreth 4.3 herë më i lartë se mesatarja europiane prej 7.4% dhe rreth 5.5 herë mbi mesataren e Europës Jugore, prej 5.8%.

Shqipëria paraqitet gjithashtu shumë më keq se vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Për periudhën 2023–2025, pasiguria ushqimore e moderuar ose e rëndë vlerësohet në 9.2% në Maqedoninë e Veriut, 9% në Malin e Zi, 8.7% në Bosnjë-Hercegovinë dhe 6.7% në Serbi.

Brenda grupit të përgjithshëm, 8.3% e popullsisë së Shqipërisë klasifikohet në pasiguri të rëndë ushqimore.
Pasiguria e rëndë lidhet me situata kur familjet mbeten pa ushqim, konsumojnë më pak sesa u nevojitet, përjetojnë uri ose kalojnë një ditë të plotë pa ngrënë për shkak të mungesës së parave apo burimeve të tjera.

Treguesit për fëmijët kanë shënuar përmirësim. Përqindja e fëmijëve nën pesë vjeç me zhvillim të vonuar fizik ra nga 16.5% në vitin 2012 në 7.4% në vitin 2024. Edhe mbipesha te fëmijët u reduktua nga 20.9% në 16.7%.
Në kahun e kundërt ka lëvizur obeziteti te të rriturit. Në vitin 2024, ai prekte 24.1% të popullsisë mbi 18 vjeç, nga 17.8% në vitin 2012. Numri i të rriturve obezë vlerësohej në rreth 500 mijë.
Edhe anemia te gratë e moshës 15–49 vjeç është përkeqësuar, duke u rritur nga 20.1% në vitin 2012 në 24.7% në vitin 2023.

Dieta ditore e shqiptarëve, 70% më e shtrenjtë se në 2017-n dhe 30% mbi mesataren europiane
Në vitin 2025, kostoja minimale e një diete të shëndetshme në Shqipëri arriti në 5.16 dollarë ndërkombëtarë, sipas barazisë së fuqisë blerëse, për person në ditë.

Kostoja është rritur nga 3.04 dollarë në vitin 2017, duke u shtrenjtuar me rreth 70% deri vitin e kaluar, sipas raportit më të fundit "Gjendja e Sigurisë Ushqimore dhe Ushqyerjes në Botë 2026".

Dieta e shëndetshme në Shqipëri rezulton rreth 30% më e shtrenjtë se mesatarja europiane prej 3.97 dollarësh dhe 12% mbi mesataren e Europës Jugore prej 4.62 dollarësh. Sipas metodologjisë së FAO Vlera prej 5.16 dollarësh është kostoja minimale ditore e një diete të shëndetshme për një person në Shqipëri.

Ajo llogaritet duke zgjedhur ushqimet më të lira që sigurojnë energjinë dhe larminë e nevojshme ushqimore dhe tregon pragun minimal ekonomik për një ushqyerje të ekuilibruar.
Pavarësisht shtrenjtimit, përqindja e shqiptarëve që nuk mund ta përballojnë financiarisht një dietë të shëndetshme ka rënë ndjeshëm. Në vitin 2025, ajo vlerësohej në 11.9% të popullsisë./Monitor

KOMUNIKIMI NUK ËSHTË QEVERISJE

LUAN RAMA

Ka një mënyrë shumë të thjeshtë për të kuptuar se çfarë mendon. Kryeministri për veten dhe punën që ai bën: të shohësh se çfarë zgjedh të tregojë.

Në politikë, komunikimi nuk është dekor. Është pjesë e pushtetit. Ai përcakton çfarë i duhet dhënë publikut, çfarë vendoset në qendër të debatit dhe, mbi të gjitha, çfarë kërkohet të identifikohet me suksesin e qeverisë. Pikërisht për këtë arsye, mënyra se si Edi Rama komunikon publikisht duhet lexuar jo thjesht si një seri postimesh në Facebook, por si një strategji politike komunikimi. Kam lexuar një për një 110 postimet që Kryeministri ka bërë nga 1 gushti deri sot.

Ajo që bie në sy është një Shqipëri e parë vetëm përmes asaj që mund të tregohet: Shkolla të reja. Rikonstruksione. Investime. Rrugë. Hapësira të transformuara. Spitale e fasadat e tyre të lyera. Turizëm. Pamje të bukura. Projekte që përfundojnë e të tjera në proces pune. Plazhe të mbushura me pushues. Festë. Një Shqipëri në lëvizje, në transformim dhe në ndërtim të vazhdueshëm. Asgjë të keqe nuk ka në këtë. Çdo Kryeministër ka të drejtë, madje edhe detyrim, të tregojë punën që bën.

Mirëpo këtu fillon edhe problemi: a është kjo qeverisje, apo komunikim? Sepse nuk janë e njëjta gjë. Komunikimi ka të bëjë me atë që pushteti zgjedh t'i tregojë publikut. Ndërsa qeverisja, pra edhe Kryeministri, gjykohet edhe nga problemet që pushteti nuk arrin t'i zgjidhë. Një shkollë e re është komunikim. Cilësia e mësimdhënies, niveli i nxënësve e studentëve është qeverisje. Një rrugë e re është komunikim. Mënyra se si është ndërtuar dhe se sa gjatë do të rezistojë pa u prishur ajo rrugë është qeverisje.

Një spital i rikonstruktuar është komunikim. Por shërbimi që merr qytetari brenda tij dhe se si zgjidhet problemi i mungesës së ilaçeve e pajisjeve është qeverisje. Një reformë e shpallur është komunikim. Rezultati i saj është qeverisje. Një premtim, fjala vjen premtimi i përsëritur i Kryeministrit në çdo fushatë zgjedhore prej asaj të vitit 2013 e më pas pa e harruar asnjëherë për sigurimin e ujit të pijshëm, është komunikim. Mbajtja e tij është qeverisje. Komunikimi merret me atë që duket. Qeverisja me atë që funksionon. Këtu kontradikta bëhet e dukshme. Dhe e nxjerr zbuluar Kryeministrin.

Në fjalimet e fundit, duke analizuar shkaqet e protestës, vetë Kryeministri ka pranuar se administrata nuk funksionon siç duhet dhe ka theksuar se shumë institucione të qeverisjes nuk e kanë qytetarin në qendër. Madje ka thënë me të drejtë se përvoja e qytetarëve e zhbën propagandën e qeverisë. Për ta ilustruar këtë, ai disa herë ka përmendur shembullin e nënës së një miku të tij, e cila shkonte në protestë e shtyrë nga përvoja e vet, siç argumnetoi Kryeministri. Sepse i duhej të shkonte që në mëngjes herët në poliklinikë për

të zënë radhën dhe për të pritur mjekun, i cili shkonte në punë në orën 10:00.

Pra, Kryeministri nuk është se nuk i njeh problemet. Por në Facebook-un e tij këto probleme nuk ekzistojnë. Në Facebook-un e tij administrata shtetërore është në rregull, e gjitha në shërbim të qytetarëve. Institucionet e qeverisjes nuk kanë probleme. Shërbimet nuk mungojnë. Reformat nuk dështojnë. Aty qeveria punon, ndërton, inauguron, transformon. (Edhe fiton, por kjo është temë tjetër!) Gjatë këtyre ditëve të gushtit, të cilat janë edhe ditët që unë kam marrë të analizoj postimet e Kryeministrit, Shqipëria është përfshirë nga zjarre të shumtë të shtrirë në të gjithë territorin e vendit. Por, në 110 postime, nuk janë as pesë që lidhen me situatën e zjarreve. Edhe ato pak postime janë falënderime për zjarrfikësit, Forcat e Armatosura dhe punonjësit e tjerë që u përballën me flakët. Shumë mirë se ata meritojnë çdo falënderim. Madje meritojnë edhe më shumë se vetëm falenderimet, duke filluar me rritjen e pagës së tyre.

Mirëpo, asnjë problem nuk vëren Kryeministri i vendit përballë kësaj situate?! Asnjë problem nuk ka në kushtet e punës së zjarrfikësve, në mungesën e pajisjeve, në kapacitetet njerëzore, në sistemet e parandalimit dhe të administrimit të zjarreve?! Këto janë qeverisje. Por nuk janë pjesë e komunikimit. E njëjta gjë ndodh edhe me turizmin.

Vlora, Saranda, Himara, Dhërmiu, Ksamili, Shëngjini, Qeparoi, Durrësi, Thethi e Lura dhe zona të tjera shfaqen përmes imazheve të zgjedhura me kujdes. Por në të njëjtat zona ka pasur edhe zjarre, shfaqje dhune, konflikte e aksidente të rënda me humbje jetësh njerëzore. Ka pasur edhe ngjarje kriminale, si vrasja e turistit portugez në Ksamil. Asnjë nga këto ngjarje nuk mbërrin në vëmendjen e Kryeministrit? Apo kjo është një Shqipëri tjetër, jo ajo që zgjidhet për t'u treguar? Edhe një shembull. U shpall me shumë bujë para disa ditësh një aksion për prishjen e një ndërtimi pa leje në ishullin e Sazanit. Lajmi u shpërnda me përkujdesje të lartë shtetërore gjithkund. Por askush nuk tha se si u ndërtua? Si u lejua të shkelej ligji? Ku ishin institucionet që kishin për detyrë ta parandalonin? Sepse qeverisje nuk është vetëm të prishësh atë që u ndërtua pa leje. Është të mos lejosh që të ndërtohet. Si përfundim, problemi nuk është se Kryeministri komunikon shumë. Problemi është se komunikimi paraqitet si qeverisje. Një fotografi nuk është rezultat. Një inaugurim nuk është sukses. Një projekt i përfunduar nuk është domosdoshmërisht një problem i zgjidhur. Dhe një Kryeministër që komunikon shumë nuk është domosdoshmërisht një Kryeministër që qeveris mirë.

Problemi nuk është vetëm çfarë zgjedh të tregojë Kryeministri. Është edhe çfarë zgjedh të mos tregojë. Sepse një vend nuk qeveriset me fotografi. As me postime në Facebook! Qeverisja nuk matet me atë që Kryeministri zgjedh të postojë në Facebook, por me atë që ndjen dhe përjeton qytetari. Nuk matet me fotografitë e suksesit, por me problemet që shteti arrin të zgjidhë.

GUXIMI I PASKRUPULLT PËR PROPAGANDË

LUTFI DERVISHI

Një video e një helikopteri që shuan zjarr me precizion në SHBA shitet si aksion në Shqipëri, shoqëruar me hashtagun #nëkryetëdetyrës dhe, sigurisht në krah është flamuri kombëtar shqiptar.

Një turiste australiane habitet kur Ministria e Shëndetësisë e merr rastin e saj dhe e kthen në lajm kombëtar me tone shumë pozitive. Turistja, që e gjeti veten në Google, jo vetëm nuk kish kërkuar publicitet, por madje ndihma i erdhi pasi foli me pronarin e bujtinës, ndërkohë që nuk u mor dot vesh me numrin e urgjencës 112.

Është bërë pothuaj rutinë që bukuritë natyrore të Shqipërisë, sidomos ato ku ende nuk ka mbërritur dora e "investitorëve strategjikë", të paraqiten si arritje të qeverisë. A thua se malet, lumenjtë, deti dhe kanionet janë vepra publike të përfunduara në këto mandate të qeverisë dhe jo dorë e Perëndisë.

Një deputete postonte këto ditë të nxehta videon e vizitës te një pensionist, që sipas saj kishte nevojë për të bërë pazarin. Deputetja kishte menduar edhe për vapën: i kishte çuar disa birra të ftohta. Kamera, natyrisht, hyri krejt rastësisht, bashkë me birrat në shtëpinë e pensionistit.

Nuk di a ka mbetur kush pa u bezdisur nga inspektimet e famshme në kantieret ku, sipas videove, punohet gjithmonë "me ritme të larta", por nuk kuptohet

pse rruga nuk mbaron kurrë.

Çfarë fitohet nga kjo propagandë e shfrenuar, e shëmtuar dhe tashmë shumë bajate? A shuhen zjarret në Shqipëri duke postuar helikopterë që shuajnë flakët në SHBA? A funksionon më mirë urgjenca kur historia e një turisteje kthehet në propagande? A përfundon më shpejt një rrugë po ta inspektosh dhjetë herë?

Guximi për propagandë po ia kalon edhe guximit të ushtarit të mirë Shvejk. Në fakt guximi i Shvejkut, ishte brenda parametrave të pranueshëm.

Është një propagande që ka kohë që përpiqet jo vetëm të zbukurojë realitetin, por edhe ta zëvendësojë atë

Por ndonjëherë realiteti nuk pret gjatë për t'u hakmarrë.

Vetëm 24 orë pasi ministri i Brendshëm dhe ai i Turizmit garantonin në video siguri maksimale për turistët dhe pushuesit, në Sarandë e Ksamil, pasuan dy ngjarje të rënda.

Është interesant se sa më pak punë ka për të treguar, aq më shumë rritet propaganda

Nuk është e tepërt të kujtosh thënien e Chomskyt: "Propaganda është për demokracinë ajo që kërbaçi është për shtetin totalitar"

Është koha që qeveria të kujtohet se shumë prej problemeve që sot i paraqet si beteja, kantiere apo sfida të reja premtoi t'i zgjidhte në katër vitet e para. Tani është në mandatin e katërt.

Pas kaq vitesh, #nëkrye të detyrës duhet të tregojë se çfarë punësh ka bërë qeveria dhe jo Natyra!

Të vjetra apo të reja?

Këtë pyetje e dëgjon çdo ditë. Nuk bëhet fjalë për mobilie apo makina, por për paratë.

Sot bëhen plot 61 vjet nga 16 gushti i vitit 1965, dita kur Shqipëria nisi reformën monetare që i hoqi një zero lekut me raportin: 10 lekë të vjetra = 1 lek i ri. Gjashtëdhjetë e një vjet më vonë, ne vazhdojmë të bëjmë llogaritë me një monedhë që nuk ekziston më.

"E kam rrogën një milion", mburret tjetri, kur në fakt merr 100 mijë lekë. Një drekë kushton 10 mijë lekë, por ne i fshijmë djersët sepse me gojë i paguajmë "100 mijë". Kemi arritur diçka të rrallë: jemi dhjetë herë më të pasur kur flasim, sesa kur paguajmë.

Dhe pastaj vjen rasti i një prej 12 milionë turistëve të huaj…

Ai sheh në kartëmonedhë numrin 1,000. Ne i themi: "Dhjetë mijë." Ai vendos syzet për siguri dhe sheh sërish kartëmonedhën. "Ten thousand?" "Yes." "But it says one thousand!" "Yes, but we call it ten thousand."

Në këtë pikë nuk kemi më problem aritmetik, por metafizik. Shteti ua hoqi zeron parave 61 vite më parë, por mileti e mbajti në kokë.

Gjëja më e çuditshme? Edhe ata që kanë lindur 20 apo 30 vjet pas reformës, e që nuk kanë parë kurrë me sy një "lek të vjetër", vazhdojnë të flasin me të. Është e vetmja monedhë që trashëgohet pa ekzistuar fare: gjyshi ia mësoi babait, babai djalit, dhe djali sot i thotë fëmijës se 1,000 lekë bëjnë "10 mijë".

Banka e Shqipërisë tentoi të ndërhynte edhe me fushata ndërgjegjësimi: "As i vjetër e as i ri, jam thjesht Lek!", duke pranuar se ky zakon po shkaktonte konfuzion te turistët dhe gabime në llogaritje.

Por leku "i vjetër" ka një efekt psikologjik magjik: i bën gjërat më të mëdha se ç'jane. Një apartament prej 150 mijë eurosh, i kthyer në lekë "të vjetra", hyn menjëherë në territorin e qindra milionave .

Këtë truk nuk e përdor vetëm populli, por me mjeshtëri edhe politika. Qeveritarët e kanë kthyer dikotominë lek i vjetër / lek i ri në art me me zgjedhje të lirë: kur flasin për bonus pensioni, përdorin me bujari lekun e vjetër se helbete "50 mijë lekë" tingëllojnë si pasuri e madhe te pensionisti. Por kur duhet të arsyetojnë rritjen e çmimeve, taksave apo tarifave, kalojnë menjëherë te leku i ri, ku "200 lekë" duken si një thërmijë e papërfillshme.

Së fundmi kemi edhe sagën e Euros. Derisa ekspertët e politikanët debatojnë se pse po bie Euroja (turizmi, remitancat, apo "ekonomia gri me njolla të zeza"), ndoshta shpjegimi është më i thjeshtë: Euroja ka kuptuar se përballë saj nuk ka vetëm një lek, por dhjetë. Dhe është trembur...

Si një vend që shquhet për shumë reforma e pak punë, reforma e lekut mbetet më jetëgjata në historinë tonë: shteti ia hoqi zeron nga letra, por ne ende nuk ia kemi hequr nga mendja.

Shpresa Programme
Inspiring hope & change

Stronger together.
Better together.
Shpresa together.

LISTENING CAMPAIGN 2026

ACROSS ALL SHPRESA PROGRAMME PROJECTS

Listening, Learning and Leading Together

We want to listen to you so we can learn together and lead together for a stronger future.

WE LISTEN to your experiences

WE LEARN from your ideas

WE LEAD together for a better future

WE GROW together as a community

QUESTIONS FOR THE LISTENING CAMPAIGN

1. What worked well for you during the past year?
2. What can we improve?
3. How would you like to be involved in this journey together?
4. What has helped you the most from Shpresa Programme?
5. What activities or support would you like to see more of?
6. What priorities should our community focus on in the future?

YOUR VOICE MATTERS!

YOUR VOICE LEADS OUR ACTIONS!

Thank you for being part of the change

www.shpresa.org | Shpresa Programme | @shpresaprogramme | info@shpresa.org

ANALIZA E DW KËRCËNIMET E VUÇIQIT ME NDALIMIN E UJIT: FORCË APO DOBËSI?

DW

Presidenti serb Aleksandar Vuçiç kërcënon të devijojë rrjedhën e lumit Ibër në përgjigje të lëvizjeve të Prishtinës. Retorika radikale si shenjë force apo dobësie?

Masat e autoriteteve në Prishtinë ndaj komunitetin serb në Kosovëkanë shkaktuar pakënaqësi në Beograd, dhe si një kundërpërgjigje, Aleksandar Vuçiq përmendi mundësinë e ndryshimit të rrjedhës së lumit Ibër. Të shohim, siç tha Vuçiq, se "çfarë do të bëjnë shqiptarët dhe si do të sillen pastaj".

Sistemi i ujit Ibër-Lepenc është me rëndësi strategjike për furnizimin e Kosovës me ujë të pijshëm dhe për prodhimin e energjisë. Prandaj, është e kuptueshme që ky mesazh kërcënues ka shkaktuar shumë shqetësim në Kosovë dhe në qarqet ndërkombëtare.

Prishtina thekson se e drejta ndërkombëtare dhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e burimeve ujore ndërkufitare ndalojnë shprehimisht përdorimin e ujit si armë ose mjet presioni politik. Ibri është një rrjedhë ujore ndërkombëtare, e cila fillon në Mal të Zi, rrjedh nëpër Kosovë dhe më tej nëpër Serbinë Qendrore ku derdhet në Moravën Perëndimore. Me ndryshimin e rrjedhës, do të rrezikoheshin edhe vendet e tjera në pellgun e Danubit.

Ëndrrat epike të Aleksandar Vuçiqit

Ekspertët në Serbi paralajmërojnë se kjo është një punë shumë e madhe që mund të zgjasë me dekada. Do të kërkonte shuma të mëdha parash, dhe ridrejtimi i rrjedhës natyrore të lumit përmes terrenit shkëmbor të Maleve Dinarike do të kërkonte punime të gjera tokësore, ndërtimin e tuneleve dhe digave.

Një ndërhyrje e tillë do të kërcënonte gjithashtu një katastrofë ekologjike në të gjithë pellgun e lumit. Profesori në pension i inxhinierisë hidraulike dhe hidrologjisë, Jovan Despotoviq, i tha FoNet se deklaratat e Presidentit serb Aleksandar Vuçiq për ndryshimin e rrjedhës së Ibrit janë "si të ecurit në gjumë dhe se ky është një projekt që nuk mund të zbatohet në një kohë të shkurtër pa shkatërruar kodra e male, dhe as nuk merret në konsideratë sipas rregulloreve evropiane".

Ide të reja megalomane

Kur bëhet fjalë për Presidentin e Serbisë, është e vështirë të thuhet se atij i mungojnë idetë megalomane. Kjo është arsyeja pse është e vështirë të vlerësohet nëse kjo është një performancë tipike për audiencën vendase që do të harrohet shpejt, apo nëse ai e mendon vërtet.

Sidoqoftë, Vuçiqnjoftoi se kishte iniciuar formimin e një grupi pune të përbërë nga inxhinierë dhe ekspertë ndërtimi, i cili do të shqyrtonte mundësinë e ndryshimit të rrjedhës së lumit Ibër. Ai e sheh këtë si të drejtë sovrane të Serbisë për ta bërë këtë në territorin e saj.

Ndërrimi i rrjedhës së lumit Ibër lindi si një ide në vitin 1985, e meqenëse Memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve (SANU) u punua gjatë atyre viteve, ai përmendet shpesh në atë kontekst politik, por ideja përfundimisht u braktis.

Fantazitë e nacionalistëve serbë

Kryetari i Bordit Drejtues të Forumit për Marrëdhënie Etnike, Dushan Janjiq, i tha DW se "nga Vuçiqi mund të pritet çdo gjë, por unë nuk prisja që ai të kthehej në vitet 1983-1985, kur filluan fantazitë e nacionalistëve serbë. Duke ndryshuar rrjedhën e lumit Ibër, ata donin ta shlyenin Kosovën, dhe kjo tregon se ata nuk donin të merreshin me Kosovën përveçse në nivelin e premtimeve dhe sloganeve për Kosovën si 'zemra e Serbisë'. Unë gjithashtu e shoh këtë si përpjekjen e tij për t'iu shmangur përgjegjësisë për gjithçka që bëri në lidhje me Kosovën - dhe ndoshta edhe më gjerë - për të fituar një alibi në këtë trazirë politike dhe për të thënë se nuk mund të ishte bërë asgjë më shumë", thotë Janjiq.

Ajo që është veçanërisht shqetësuese, sipas tij, "është se objektivisht ky nuk është një projekt racional. Ky nuk është një projekt që zgjidh një problem, por më tepër një projekt ideologjik dhe propagandistik - nëse mund ta quajmë kështu - i cili shërben për të krijuar edhe më shumë trazira dhe zhurmë në rajon, në mënyrë që njerëzit të mendojnë se pa ju nuk ka shpëtim dhe se do të ketë një përmbytje", vlerësoi Janjiq për DW.

Serbët jetojnë edhe në Kosovë

Duket se ai nuk e ka menduar fare se uji në Kosovë nuk është i nevojshëm vetëm për shqiptarët dhe se ndrysimi i rrjedhës do të rrezikonte edhe komunitetin serb në Kosovë.

Dushan Janjiq vëren se "kërcënimi për të dëmtuar shqiptarët është fjalë boshe, sepse për shembull, kanali Danub-Tisa-Danub u ndërtua për 20 vjet në një shtet shumë më të organizuar dhe të pasur, ndërsa ndryshimet në Ibër do të zgjasnin 50 vjet".

Pra, Vuçiç vështirë se do të jetë në gjendje të shohë se si do të vuajnë shqiptarët, por do të dëmtoheshin të gjithë banorët e Kosovës. E ajo që tashmë është dëmtuar padyshim është imazhi i vetë Serbisë dhe udhëheqjes së saj. "Sepse, kur dilni publikisht me deklarata të tilla, të gjithë do të pyesin veten nëse ky është një partner me të cilin duhet të punohet", paralajmëron Janjiq.

Sa shumë e rrezikojnë këto lloj deklaratash pozicionin e serbëve në Kosovë? Bashkëbiseduesi ynë beson se "pozicioni i komunitetit serb në terren është dëmtuar me monopolin e Listës Serbe. Ky pozicion është çimentuar nga një korrupsion shoqëror i aktorëve aktivë politikë midis serbëve, nuk ka sistem shumëpartiak në atë komunitet, dhe për fat të keq Bashkimi Evropian (BE) ndihmoi në prishjen e tij. Demokracia dhe sistemi shumëpartiak thjesht nuk ishin temë e normalizimit", vëren Janjiq.

Misionari apo Sizifi?

Presidenti i Serbisë është përballur gjithashtu me kritika të shumta në frontin e brendshëm, Kreu i partisë Qendra e Serbisë (SRCE), Zdravko Ponosh, tha se "ndërsa Vuçiq praktikon të bëhet misionar, ai së pari duhet të përpiqet të zgjidhë problemin e ujërave të zeza në Borçë (paralagje e Beogradit)".

Megjithatë, Dushan Janjiq beson se një krahasim tjetër është shumë më i përshtatshëm: "Mendoj se ky është me të vërtetë një dimension epik i këtyre paraqitjeve si pjesë e fushatës zgjedhore, por më duket gjithashtu se këtu kemi të bëjmë më shumë me mitin e Sizifit. Kjo është arsyeja pse e gjithë politika e jashtme tani është e angazhuar në amortizimin e gjithçkaje që po ndodh në nivel të brendshëm për të ruajtur pushtetin", pohon Janjiq në prononcimin e tij për DW.

DYQANET QË NA JEPNIN FALË AROMËN

DAUT DAUTI



Në anën e majtë të rrugës kryesore që çonte në qendër të qytetit, ka qenë një shtëpi dykatëshe. Në katin e parë ka qenë një ëmbëltore dhe një punëtori rrobaqepësie.

Shtëpia ishte e rrobaqepësit, axhës Shukë, i cili nga dritarja shihej i ulur para makinës qepëse "Singer".

Pas tij, gjithmonë me kokë ulur, duke qepur herë me dorë e here me makinë, shiheshin edhe tre punëtorë të tjerë. Rrobaqepësi mbante një fes të zi në kokë, që për ne njihej si kapelë e bejlerëve.
Ai ishte i dobët nga shëndeti, por energjik me lëvizje të shpejta të duarve dhe njeri i respektuar në qytet. Pranë tij, teksa punonte, vazhdimisht ishte dikush ulur, ndonjë myshteri apo edhe kalimtar i rastit me të cilin ai bisedonte.

Në anën tjetër të rrugës, mu përballë rrobaqepësit, qëndronte një shtëpi e madhe e ndërtuar para qindra vjetëve. Shtëpia ishte me siguri më e madhja në qytet, siç ishte edhe familja që jetonte në te.
Ata mbanin edhe dele, që kur i nxjerrnin në mëngjes për t'i dërguar në kullota, e bllokonin atë pjesë të qytetit.
Disa metra më tutje, në anën e njëjtë të rrugës, gjendej një shitore që e quanim

Dyqani i Nazifit, sipas emrit të shitësit. Shitorja ka qenë një godinë e ulët përdhese me dritare dhe dyer të vjetra. Hapësira brenda ka qenë e errët, por plot mallra.

Sapo kalohej pragu i derës, ndjehej një arome e këndshme e përzier e mallrave pasi që shitorja ishte e tillë. Banaku i shitores gjendje në të djathtë, në anën e dritares, kurse në të majtë qëndronin dy fuçi të mëdha të metalta mbi të cilat shihej nga një hinkë llamarine.

Njëra fuqi mbante vaj kurse tjetra vajguri, të cilit ne atëherë i thoshim gaz. Kur blinim vaj, merrnim shishen nga shtëpia dhe shkonim te dyqani.

Shitësi e merrte shishen dhe në te e vendoste hinkën. Ia hiqte kapakun fuçisë dhe me një tas nxirrte vaj për ta mbushur shishen.
Pastaj e mbyllte shishen e cila për kapak zakonisht kishte një boçë misri.
Pas fuqive, të palosur qëndronin thasët me miell.

Më tutje, në disa rafte anash rrinin topat e stofrave dhe tekstileve.
Para banakut qëndronin tre apo katër sëndukë me sheqer, oriz, krip dhe çaj. Nga këtu, shitësi nxirrte mallin e dëshiruar me një lloj luge të metaltë, e vendoste në një qese të letrës dhe pastaj e vinte mbi vagë për ta matur.

Qeset, të madhësive që zinin një apo dy kilogramë, ishin të prodhuara nga një letër e trashë ngjyrë kafe, të cilat edhe sot përdoren në Amerikë dhe gjetiu.

Mbi banak, një mbi një, qëndronin kavanozat e qelqtë me grykë të kthyer kah shitësi, i cili mbante veshur një mantel të hollë e të kaltër e që ishte uniforma e tij e punës.
Kavanozat ishin të mbushura me karamele dhe sheqerka të disa llojeve. Ky ishte vendi ku ne fëmijët ndaleshim më së shumti.

Sado para që kishim, ia tregonim axhës Nazif dhe pastaj llojin e sheqerkave që i dëshironim. Ai vendoste për sasinë që do të na shiste. Me shpejtësi të stërvitur i afrohej topit të letrës që mbante mbi banak, e rrotullonte dhe shqyente madhësinë që i dukej se ishte tamam.
Duke i lëvizur duart, sikur magjistar, e sillte letrën rreth dorës dhe krijonte një lloj koni të cilit ne i thoshim fitil, dhe aty ai i fuste sheqerkat. Pastaj i vendoste në tasin e madh të vagës kurse në atë të voglin i vendoste ato metalet që ishin njësi matëse.
Ne më shumë e shikonim këtë pjesën ku vendosej pesha matëse, pasi nga aty e dinim sa sheqerka do të merrnim. Dëshpëroheshim gjithmonë, sepse kurrë nuk merrnim sa dëshironim. Megjithatë, nga shitorja dilnim të gëzuar.

Ngjitur me shitoren ishte një lloj dyqani tjetër ku një jevg ushtronte profesionin e vullkanizerit.

Para dyqanit ai kishte një koritë me ujë të ndotur dhe një gomë të madhe traktori të cilin e mbante aty, si reklamë, për të treguar së çfarë pune bënte. Brenda nuk shihej që kishte shumë mjete, pos gërshërëve, ngjitësit dhe ndonjë gjëje tjetër të vogël. Nuk e kishim të qartë se si punonte ai. Unë për vete kurrë nuk e kam parë duke rregulluar ndonjë gomë, por e dija se disa nga shokët e mi ndonjëherë aty ngjitnin pjesët e shqyera të gomave të brendshme të biçikletave.

Përballë këtyre dy dyqaneve një rrugë hynte në lagjen "7 Korriku". Në kënd të saj një serb sapo e kishte ndërtuar një shtëpi të madhe e të bukur.

Në kat të parë ai e hapi një dyqan modern i cili, pos kafeneve dhe hotelit, ishte vendi i parë që filloi të shiste kokakolë. Kjo ishte arsyeja pse ne shkonim aty.

Para këtij dyqani shpesh shiheshin të rinjtë duke blerë kokakolë dhe duke i pirë ato në hapësirën e gjerë të trotuarit. Ne fëmijët i shikonim me lakmi këta të rinj. Ishin të veshur bukur, kishin ndonjë transistor me vete për të dëgjuar muzikë, të cilës ne atëherë i thoshim argëtuese.

Kur nuk dëgjonin muzikë nga transistori, këndonin vetë. Këta kishin flokë të gjata dhe visheshin e silleshin duke i emituar të rinjtë e Perëndimit në kohën kur rok-grupi The Beatles kishte okupuar kulmin e muzikës së këtij lloji.

Ne fëmijët aspironim të bëheshim si këta kur të rriteshim. E mbaj mend kur jam ulur në shkallët e kësaj shitoreje për ta pirë kokakolën. E pija ngadalë se më dhimbsej nëse harxhohej. Duke e çuar shishen te goja, mendoja se kështu duhej të ishte jeta në Amerikë dhe se unë me siguri dukesha si amerikan.

PRESHEVA NUK MUND TË KETË DY STANDARDE

ARDITA SINANI

Presheva nuk është vetëm një pjesë e hartës që vizitohet kur dikujt i duhet. Presheva është shtëpia e qytetarëve që kërkojnë të njëjtën vëmendje, të njëjtat të drejta dhe të njëjtin trajtim nga shteti. Çdo investim në Strezoc, Mamincë, Svinjishtë, Slavujevc apo në cilindo vendbanim të Komunës së Preshevës është i mirëseardhur. Ne nuk kemi qenë dhe nuk do të jemi kundër asnjë investimi që përmirëson jetën e qytetarëve tanë.

Por sot, pas vizitës së Presidentit Vuçiq në Preshevë, nuk mund të mos them atë që qytetarët e mi e shohin dhe e përjetojnë çdo ditë:
Presheva nuk mund të ketë dy standarde.
Ne, si Komunë, nuk i ndajmë qytetarët sipas përkatësisë etnike. Këtë e kemi dëshmuar me punë, jo me fjalë. Kemi përgatitur projektin për shkollën në Mamincë, kemi investuar në kanalizimin e këtij fshati dhe kemi realizuar fazën e parë të asfaltimit të rrugës drejt Svinjishtës. Sepse për ne, banori i Mamincës, i Strezocit, i Svinjishtës apo i çdo vendbanimi tjetër është mbi të gjitha qytetar i Komunës së Preshevës.
Por të njëjtin standard që e zbatojmë ne, kemi të drejtë ta kërkojmë edhe nga shteti.

Kemi kërkuar zyrtarisht investime për Shkollën "Prof. Ibrahim Kelmendi", për shkollën në Mamincë, për çerdhen "8 Marsi" dhe për projekte të tjera që lidhen drejtpërdrejt me jetën e qytetarëve tanë.

Prandaj, kur dëgjojmë për investime që mund të realizohen brenda pak javësh në një pjesë të komunës, pyetja është e thjeshtë:

Pse qytetarët shqiptarë duhet të presin me vite për përgjigje, projekte dhe investime nga institucionet qendrore?

Nuk kërkojmë që të merret nga njëri për t'i dhënë tjetrit.

Kërkojmë të mos merret nga shqiptarët për t'u dhënë të tjerëve. Rrugët e reja janë të mira. Shkollat e renovuara janë të mira. Vendet e reja të punës janë të mira. Por ato janë të mira vetëm kur janë pjesë e një politike të barabartë për të gjithë qytetarët.
Në Preshevë jetojnë shqiptarë, serbë, romë dhe qytetarë të komuniteteve të tjera. Ne duam që secili të jetojë më mirë. Por kjo nuk mund të përdoret si arsyetim për ta bërë shqiptarin të padukshëm para shtetit.

Presidenti i Republikës, Qeveria dhe institucionet e Serbisë duhet ta dinë se kanë përballë një komunë që është e gatshme për bashkëpunim, por jo për heshtje.
Ne nuk kërkojmë privilegje. Kërkojmë barazi.
Nuk kërkojmë më shumë se të tjerët. Kërkojmë të mos marrim më pak. Nuk jemi kundër zhvillimit të askujt. Jemi kundër diskriminimit të kujtdo.
Presheva është një komunë.
Qytetarët e saj janë qytetarë të barabartë.

Dhe si Kryetare e Komunës së Preshevës, do të vazhdoj ta them qartë në Preshevë, në Beograd, në Prishtinë, në Tiranë dhe para kujtdo që duhet ta dëgjojë:
Shqiptarët e Preshevës janë këtu. Janë qytetarë. Kanë nevoja. Kanë të drejta. Dhe nuk do të pranojmë të trajtohemi si qytetarë të dorës së dytë ose që nuk ekzistojnë fare.

Dotech
Websites

POROSISNI
BUSINESS CARDS
Profesionale

PËR BIZNESIN TUAJ!

Mos rrini anonim – jepini frymëmarrje biznesit tuaj.

Kartat profesionale të biznesit janë mënyra më e thjeshtë dhe më efektive për të lënë një përshtypje të parë të shkëlqyer te klientët tuaj.

NE U KUJDESEMI PËR:

- DIZAJN MODERN DHE PROFESIONAL
- PRINTIM ME CILËSI TË LARTË
- DORËZIM ME POSTË NË TË GJITHË MBRETRINË E BASHKUAR
- CMIME TË ARSYESHME

Dizajnojmë ne, | **JU DËRGOJMË ME POSTË!**

NA KONTAKTONI:
020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

ADRESA E ZYRËS:
30 Avenons Road,
London, E13 8HT

WEB DESIGN | SEO | E-COMMERCE | DIGITAL MARKETING

PLAKU ME BASTUN, SI ANTIMODELI NDAJ NJË PUSHTETI TË SHURDHËT

ANDI BUSHATI

Pamjet ikonike të një të moshuari nga Maliqi që kërcënonte me bastun kreun socialist të këshillit bashkiak, shkojnë shumë përtej tensioneve që ka ngjallur përpjekja e qeverisë për ti imponuar një ndarje të re teritoriale vendit.

Problemi nuk është as se po injorohet çdo pretendim i bërë nga opozita në komisionin bipartizan, as se për shumë qendra, aksesi në bashki po bëhet gjithnjë e më i largët.

Duke e reduktuar me 15 numrin e bashkive aktuale socialistët pretendojnë krijimin e administratave më të fuqishme dhe më mëkëmbura financiarisht, që do i përgjigjeshin më mirë qytetarëve.

Por pyetja shtrohet: si po e bëjnë këtë?

Në këtë pikë imazhet simbolike të një të moshuari nga Selca, Reiz Petritajt, që u ngriti shkopin në fytyrë autoriteteve të Maliqit, tregojnë shumë. Maliqi është një nga ato qendra që synohet të shkrihet në të ardhmen me Korçën.
Kryebashkiaku veteran i tij, Gëzim Topçiu ishte shprehur publikisht kundër kësaj zgjidhjeje. Por këtë të enjte, me sa duket nën presion të madh ai, po ashtu si këshilltarët socialistë kanë bërë prapaktheu. Pse? Nga shantazhi dhe presioni? Ky është opsioni më i mundshshëm, po të kthesh filmin pas dhe të shohësh se ç'ka ndodhur deri më sot.

Të revoltuar me projektin e ndarjes territoriale, socialistët e Poliçanit dolën në shesh dhe dogjën në mënyre demostrative tesrat e partisë së tyre. Të njëjtën gjë bënë dhe ata të Divjakës që vazhdojnë çdo mbrëmje protestën. Por, ndaj kësaj revolte jo të kundërshtarëve, por të të vetëve, kryeministri Rama u përgjigj me arrogancë dhe harbutëri. Ai e fyeu dhe e ofendoi gjatë mbledhjes me krerët lokalë, kryebashkiakun e Poliçanit duke i kujtuar "turpin" e djegjes së tesrave.
Ai u tall me homologen e tij të Dimalit, duke ironizuar me "udhëheqësit e mëdhenj", që guxojnë të vënë trurin në punë për të dyshuar mbi vendimet që merren lart, ndërsa pasi Juliana Dedaj iu përgjigj se ajo s'ndihej si "udhëheqëse e madhe", por si "punëtore komunaleje: kryeministri e kërcënoi me nxjerrje jashtë.

Pikërisht ky injorim për të dëgjuar zërat e drejtë apo të gabuar qofshin, që i vijnë nga baza e që pastaj shndrrohet në shantazh për të zbatuar urdhrin, mund të ketë zbythur edhe kryebashkiakun e Maliqit, Topçiu.

Prandaj publiku pa sot ato imazhe domethënëse nga salla e këshillit bashkiak. Ato tregojnë vetëm një gjë: revoltën qytetare ndaj një pushteti që nuk ka më nerva as që ti dëgjojë. Në vend të bindjes, rilindja gjithnjë e më shumë po përdor një armë tjetër: dhunën dhe nënshtrimin.

Nuk ka argument më të fortë për këtë pretendim sesa një kryebashkiak i PSsë që detyrohet të kthejë pllakën me presion. Nuk ka shembull më sinjifikativ se ata socialistët e Dimalit, Poliçanit apo Divjakës që duan të dëgjohen, por në të kundërt tallen dhe përçmohen.

E këtu nuk po gjykojmë nëse ata kanë të drejtë apo gabim. Nëse ndarja e re teritoriale mund të krijojë më shumë të mira apo jo për qytetarët e bashkive që shkrihen. Këtu problemi është thjeshtë për metodën që po aplikohet: "Ju jeni tufë bagëtish, të mirën tuaj e dimë ne, ndaj s'ka nevojë as ti'u pyesim".

Ky është shtrati nëpër të cilin po ecën reforma teritoriale. Ky procedim, bie katërcipërisht ndesh me propagandën e platformës Besa, që vetë Edi Rama shpalli pak ditë më parë.

Një ndër pikat e këtij dokumenti që mëtonte ti përgjigjej protestave masive kundër drejtimit autoritarist të vendit ishte më shumë empati ndaj qytetarit, për ti shpjeguar atij edhe ato vendime të drejta që si kupton se janë në të mirë të tij.

Por, kur vjen puna në zbatimin në praktikë sjellja është tjetër: ata që kanë poste dhe nuk binden kërcënohen, ndërsa ata që kanë vetëm pushtetin për të protestuar, përqeshen e injorohen.
Dhe kjo ndodh pasi ky pushtet ka vite që është i shurdhër.
Fakti që nuk dëgjon dot më as të vetët përbën provën më të qartë se e ka të pëmundur të sillet ndryshe. E prandaj e vetmja mënyrë komunikimi me të është ti ngresh bastunin.

EDI RAMA, ALIAS DËSHTAKU

ARTAN HOXHA

Edi Rama, plot 13 vite Kryeministër, ardhur në shtator 2013 me premtimet e bujshme dhe 1 milion vota për të rilindur Shqiperine, ndersa bën sot bilancin qeverisës, sipas tij të ndritur, ne fakt i numërohen rrumbullak plot 13 dështime të medha (pa llogaritur të voglat e shumta)

1. Premtoi rrugë europiane, sot shqiptarët pësojmë gjoba dragoniane ndërsa rrugët e "florinjtë" , ca i shemben e ca i perfundojne në hinka torturonjese, pa ndriçim e pa sinjalistike, e ku vozisim të gjithe me kokën në traste.

2. Premtoi ujë të pijshëm 24 orë, e ripërsëriti premtimin paturpesisht çdo mandat, pa rezultat - rrofshin pompat dhe depozitat majë taracave - mirë që nuk na i hoqen.

3. S'la gjë pa thënë për të pergerat që derdheshin në det, siç na gjeti të fundit na la po te fundit ne Ballkan për

shkallën e perpunimit të ujërave të zeza, ne fakt me rënie në ketë tregues sipas statistikave europiane ndonëse paraja është harxhuar lumë.

4. E nisi me aksione tip "fundjava ndryshe" për pastrimin e plehrave, jemi sot me plehrat nëpër këmbë, ne lumenj e dete, me 2 inceneratore që s'djegin dhe i treti që s'ekziston dhe industri riciklimi të shpartalluar

5. Premtoi se do shpëtonte pyjet nga zjarret me avionë dhe helikopterë, përfundoi me video të vjedhura nëpër botë shitur për suksese vendase.

6. E nisi me kujdesin per bregdetin, pastërtinë dhe menaxhimin publik, sot jemi të fundit në Europë për pastërtinë e plazheve e ujërave për notim e te paret për menaxhimin privat të tyre

7. Premtoi fluturime në aeroportin e Kukesit, i ka mbetur në dorë edhe aeroporti i shumëpërfolur i Vlorës:, u mburr me Naimin dhe Ismailin e Air Albania, e kjo falimentoi në heshtje, na rroftë emri i stadiumit me kullë në Tirane.

8. Premtoi shëndetësinë falas, përfunduam ke ilaçet e prodhuara ne botën e tretë, rendim të shpenzimeve private për shendetit dhe spitale publike ku minjtë luftohen me mace ndërsa doktoret dhe infermerët mendjen dhe vrapin e mbaj drejt e per Gjermani.

9. Premtoi arsim modern e kërkim shkencor, përfunduam me rezultate skandaloze në Testin Pisa e me rritje të "analfabetizmit funksional".

10. Premtoi rritje industriale, bujqësore, e te eksporteve ndërsa ka disa vite që këto bien e bien në vijimësi ndërsa eksportojmë zanatali e rini e importojmë punetori

11. E nisi me bujë me legalizimin dhe disiplinimin e ndërtimeve, e para vijon si burma pa fund, diferencon si ti teket tek e dyta, cave ua shemb e cave ua lë deri në qiell, ndersa ka betonizuar Tiranën dhe gjith Shqipërinë, me gjasa po na le edhe pa portin e Durrësit edhe pa flamingot në Narte

12. E nisi me luftë kunder kanabisit të Lazaratit, tashmë bashkeqeveris me krimin e organizuar të ngritur në nivelin e rolit të rëndësishëm global në trafikun e kokainës ndërsa investon kapitale marramendëse në ekonominë e vendit duke përçudnuar strukturën ekonomike e sociale.

13. Premtoi anëtarësimin e plotë në BE, mezi arriti ti hape negociatat për anëtarësim pas sulmit të Rusise kundër Ukrainës, po lutet per status të dorës së dytë (bashke me Vucic) me gjasa as këte nuk do ta arrijë 2030 se nuk heq dorë nga partia shtet e patronazhisteve rilindes.

A doni me për dështimet e Edi Ramës, alias Dështaku?!

A nuk mjaftojnë për ta përzënë me 1 milion shqelma?!

Nëse ju mjaftojne bashkojuni shqiptarëve të tjerë që protestojnë që prej tre muajsh non-stop!

Nese nuk ju mjaftojnë, ju qofshi, e gëzofshi regjimin e Dështaku!

Akoma nuk keni një website?
Akoma nuk jeni regjistruar në Google
Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona
Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT
Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob:078 5997 7545

Dotech.uk

BEJENI BIZNESIN TUAJ ME TE DUKSHEM

Porosisni banner profesional
për biznesin tuaj.

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

www.dotech.uk

PVC BANNERS

- Material i fortë PVC
- Printim me cilësi të lartë
- I papërshkueshëm nga uji
- Ideal për ambiente të brendshme dhe të jashtme

MESH BANNERS

- Material rrjetë (mesh)
- Lejon kalimin e erës
- I qëndrueshëm në çdo mot
- Ideal për ambiente të jashtme dhe skela

PREMIUM ROLLER

- Dizajn elegant dhe modern
- Printim me cilësi premium
- Stabilitet maksimal
- I përshtatshëm për çdo ambient

PULL UP ROLLER

- Lehtë për t'u transportuar
- Montim i shpejtë dhe i lehtë
- I përshtatshëm për çdo event
- Praktik dhe i qëndrueshëm

MATERIALE PREMIUM
Të qëndrueshme dhe afatgjata.

PRINTIM ME CILËSI TË LARTË
Ngjyra të gjalla, detaje perfekte.

REZISTENT NDAJ MOTIT
Diell, shi, erë – pa problem!

PËRGATITJE E SHPEJTË
Porosit sot, merr shpejt!

RRITNI DUKSHMËRINË. ZHVILLONI BIZNESIN TUAJ.

TËRHIQNI AUDIENCËN TUAJ.
Rritni interesin dhe besimin.

REZULTATE QË FUNKSIONOJNË.
Zgjidhje që sjellin rezultate reale.

BËNI NJË HAP PËRPARA.
Ne jemi këtu për ju.

www.dotech.uk

info@dotech.uk

A KA ADHUR KOHA PËR NJË ALTERNATIVË TJETËR POLITIKE?

IRENA BEQIRAJ

Shqipëria është një vend ku opinioni politik është i bollshëm. Fakti që diskutimet politike janë pjesë e çdo takimi me miqtë apo me familjen është një provë e mjaftueshme se problemi në këtë vend nuk është angazhimi politik.

Pyesni një shqiptar për qeverisjen Parlamentit a ndonjë ngjarje politike, edhe padyshim do ta merrni një përgjigje. Por kur e pyet çfarë mendon për rolin e shtetit në ekonomi , ose çfarë mendon për raportin e lirisë individuale kundrejt mirëqenies kolektive, apo a duhet të forcojmë arsimin privat apo të financojmë arsimin publik etj... biseda nuk është më aq entuziaste, madje aty mund mbyllet.

Shqipëria është një vend ku opinioni politik është i bollshëm. Fakti që diskutimet politike janë pjesë e çdo takimi me miqtë apo me familjen është një provë e mjaftueshme se problemi në këtë vend nuk është angazhimi politik. Dyshoj se problemi është kuptimësia politike, edhe fakti që sistemi politik me kast e ka fshirë ideologjinë si bazamentin e të bërit politikë edhe e diskursit politik.

Kur elektorati është i zbrazët nga ideologjia rrjedhimisht edhe politikanët janë të zbrazët nga ajo. Përshembull megjithëse kundërshtare në fushatën elektorale 2025 , tanimë Zeqineja nga Jola ndryshojnë vetëm nga flokët. Analiza pse ndryshimi i dy politikaneve të reja janë vetëm flokët , duhet të fillojë pikërisht tek fakti që në thelb ne kemi një elektorat që nuk i kërkon as Zeqinesë as Jolës e as kujdo tjetër, të shpjegohen mbi ideologjinë ku i bazojnë ato që pretendojnë edhe proklamojnë.

Një politikan që ndërton karrierën politike mbi bindjet ideologjike, e ka përcaktuar njëherë përkatësinë. Një politikan që e ndërton karrierën vetëm për pushtet mund të atashohet kudo që ndodh që t'i japin pushtet. Sot konsiderohet normale që edhe me njerëzit që merren aktivisht me politikë të jetë pa interes diskutimi i ideologjisë politike. Edhe pse duket një neutralitet i padëmshëm, kjo është pika e rrezikut. Pasi refuzon të njohësh e përcaktosh se ku beson ideologjikisht, diçka tjetër do ta mbushë boshllëkun, edhe pikërisht çfarë e ka zënë vendin e lënë bosh nga ideologjia e ka bërë politikën të dëmshme edhe të urryer.

Vini re që në mungesë të ideologjisë, gjithnjë e më shumë, politika vërtitet rreth udhëheqësve individualë dhe personalitetit të tyre, karizmës së tyre, forcës apo dobësisë së tyre, dëmeve që ata kanë sjellë në politikë ekonomi edhe shoqëri, apo avantazhit se janë të rinj të paprovuar. Boshllëku i krijuar nga analfabetizmi ideologjik mbushet kështu nga çdo gjë që është më e zhurmshme dhe më e thjeshtë për t'u ndjekur apo besuar. Kjo është arsyeja pse shoqëritë mendërisht të zbrazëta nga ideologjia janë kaq të rehatshme për të manipuluar nga populistët, edhe në këto mjedise dhe opozitat nuk e dinë më se çfarë mbrojnë.

Ndërsa mesazhet e protestës janë të qarta, "partitë ekzistuese janë të gjitha të kompromentuara në të njëjtën mënyrë" zgjidhja e vetme kërkohet tek krijimi i një partie të re të paprekur nga këto zakone, me njerëz të pakompromentuar.
Njerëzit bëjnë thirrje për një krijimin e një alternative të pastër, duke supozuar se kërkesa e tyre është e mjaftueshme për të nxitur ofertën që e përmbushë atë. Por kërkesa, për një partie të re, anashkalon pyetjen më të rëndësishme: a ekziston aktualisht mjedisi që diçka e tillë të shfaqet dhe të mbijetojë?

Në Shqipëri është provuar se dominimi elektoral, pasi është vendosur, është jashtëzakonisht kokëfortë për t'u ndryshuar; partia në pushtet ka një infrastrukturë organizative, rrjete patronazhistësh të shtrirë në çdo qelizë të shoqërisë; financimi i fushatave në Shqipëri favorizon në mënyrë dërmuese partitë e konsoliduara dhe ky hendek vetëm është zgjeruar; Qasja në media e çon pamundësinë një hap më tej. Një parti e re, ka një mbulim të papërfillshëm krahasuar me një parti ekzistuese.
Për më tepër një mjedis fertil për lindjen e alternative tjetër ka nevojë për organizata të shoqërisë civile që të reagojnë pa frikën e humbjes së privilegjeve.

Kur i gjithë sistemi politik funksionon si industri duopolistike, ku barrierat e hyrjes janë shumë të larta, a mjafton vetëm pakënaqësia, lodhja edhe irritimi nga keqqeverisja që të lindë një alternativë e re qeverisëse të ndryshme? Aq më tepër në prani të analfabetizmit ideologjik, çfarë mund ta bind qytetarin se partia apo lëvizja e re apo është alternativa e duhur e ndryshme nga ekzistueset?

Një elektorat i pakënaqur, nuk do të thotë domosdoshmërisht një elektorat i gatshëm për një alternativë të ndryshme. Një elektorat I pakënaqur, por ideologjikisht analfabet, mund të rrezojë një qeveri , por nuk është i aftë të ushtrojë presionin e nevojshëm për një qasje ndryshe.

Ndaj pyetjes se kur është momenti që disa burra e gra të mençur të bëhen bashkë për të ofruar një alternativë të re politike u përgjigjem:"ditën që do të pyesni një 18 vjeçar se në cilën ideologji politike beson , dhe përgjigja që do të merrni është e qartë edhe toni i vendosur, mund të krijohet një alternativë tjetër politike!

PSE SERBIA KËRKON TË RIHAPË KONSULLATËN E SAJ NË SHKODËR

HASAN BELLO

Historikisht, konsullatat dhe ambasadat kanë pasur gjithmonë një funksion të dyfishtë:

1. Funksioni zyrtar – përfaqësimi i shtetit, mbrojtja e interesave të qytetarëve, zhvillimi i marrëdhënieve politike, ekonomike dhe kulturore etj.

2. Funksioni informativ.

Në vitet 20-30 Jugosllavia i imponoi shtetit shqiptar, po për të njëjtat arsye që përmend sot ministri i Jashtëm, hapjen e tre konsullatave: një në Shkodër, një në Korçë dhe një në Vlorë. Që të treja luajtën një rol shumë aktiv për minimin e institucioneve kushtetuese; për nxitjen e përçarjes dhe përplasjes brenda shoqërisë dhe politikës shqiptare dhe mbi të gjitha, për rekrutimin e një rrjeti informatorësh dhe spiunësh që pas disa vitesh morën në dorë fatet e kombit shqiptar. Për ta ilustruar po përmend nga një rast për çdo konsullatë.

1-Konsullata e Shkodrës ishte nxitësja kryesore, pas agjenturës italiane, për ngjarjet e qershorit të 1924. Ende sot ekziston një relacion i Prefektit të Shkodrës, drejtuar ministrit të Brendshëm ku i raporton se një agjent i shërbimit sekret që ishte infiltruar në këtë konsullatë, e kishte informuar se së shpejti do të përgatitej një atentat kundër

disa personaliteteve që do të destabilizonte shtetin shqiptar. Në fakt, prefekti, i cili në ato vite luante edhe rolin e shefit lokal të shërbimit sekret e kishte nënvleftësuar këtë informacion. Ai e informoi ministrin vetëm pas dy ngjarjeve tepër të rënda që u bënë shkak për agravimin e situatës. Më 6 prill 1924 në pyllin e Mamurrasit u vranë dy turistë amerikanë, ndërsa më 20 prill u plagos rëndë Avni Rustemi, i cili vdiq pas disa ditësh. Të dyja ngjarjet çdo ditë e më shumë implikojnë dorën e Serbisë me anën e konsullatës së saj në Shkodër.

2-Në vitin 1932 zbulohen dhe arrestohen një numër i madh personash, ndër të cilët edhe xhaxhai i Hysni Kapos, Murat Tërbaçi si pjesëtarë të Organizatës së Fshehtë të Vlorës. Sipas hetimeve dhe dëshmive të pjesëmarrësve, kjo organizatë financohej dhe mbështetej nga konsullata jugosllave në Vlorë. Ky është një nga operacionet më të mëdha subversive të qeverisë jugosllave brenda shtetit shqiptar.

3-Konsullata jugosllave në Korçë përgatiti terrenin dhe rekrutoi një numër të madh të rinjsh shqiptarë që më vonë do të luajnë një rol të rëndësishëm në drejtimin e shtetit.

Prandaj hapja e konsullatës serbe në Shkodër është pjesë e luftës asimetrike, që Serbia bën për të konsoliduar pozitat e spiunazhit të saj me qëllim për ta përdorur atë për të destabilizuar shtetin shqiptar.

PATER HAPPEL

SANDER LLESHAJ

Për ditën e Shën Marisë jam i ftuar në Pater Walter Happel në Schalders/Scaleres të Tirolit të Jugut, Itali. Makina ngjitet në shpatin e thiktë alpin të malit, duke lënë poshtë vapën përvëluese të gushtit, e cila ende nuk guxon të prekë shenjtërinë e bjeshkës.

Sapo ndaloj në qendrën e vogël të fshatit piktoresk, nga ballkoni plot lule i një shtëpie aty më përshëndet Pater Happel. Më duket se ka mbetur i njëjti që kur e kam njohur para më shumë se 15 vjetësh, gjatë një vizite në Gjimnazin Loyola të Prizrenit.

Pasi sistemohem shpejt në shtëpinë 300-vjeçare, ulemi në ballkonin e saj plot lule të varura, prej nga duken malet e larta dhe lugina poshtë tyre, ku shtrihen Vahrn/Varna dhe Brixen/Bressanone. Pamja mahnitëse që shpaloset nga ballkoni duket sikur më kthen pas në kohë, në dritaret e kullës sime në Mirditë, kur, si fëmijë, admiroja mrekullinë e maleve plot gjelbërim e hijeshi.

Kërcitja e lehtë e shkallëve të drunjta të shtëpisë së vjetër, oshtima e thellë e lumit malor në këmbë të malit dhe aroma e bredhave që vallëzojnë prej erës më çojnë në kohë të vjetra.

Mbrëmja nuk vonon dhe një gotë verë i shtohet tryezës sonë të thjeshtë, por pa arritur të dominojë mbi magjinë që ofrojnë malet e mbuluara me bredha, teksa humbin dalëngadalë në muzg, ndërkohë që dritat poshtë në luginë, për një çast, duken si yje të largët, a thua se bota është përmbysur dhe yjet janë ulur në tokë.

Pater Happel jeton në Gjermani, por vjen këtu çdo muaj gusht prej më shumë se 25 vjetësh për të zëvendësuar famullitarin që gjen disa ditë për pushim. Teksa më flet për famullinë, tokat dhe livadhet e saj, unë e pyes për pronat e kishës.

“Përse ka kaq shumë prona kisha?” – pyes unë.

“Pronat e kishës kanë shumë burime”, – thotë Pater Happel, – “por njëri nga më të rëndësishmit janë trashëgimitë familjare të murgeshave dhe të klerikëve të tjerë, që përgjatë historisë së gjatë të kishës i kanë kaluar asaj trashëgimitë e tyre personale.”

“Po si funksionon kjo?” – e ngas unë më tej bisedën.

“Murgeshat dhe shumë klerikë të tjerë nuk mund të krijojnë pasuri personale, kështu që ato pasuri që ata trashëgojnë nga familjet e tyre i kalojnë kishës”, – është përgjigjja e Pater Happel.

“Po ju, a keni trashëguar gjë?” – pyes unë.

“Edhe unë kam trashëguar një shtëpi në qytetin tim në Gjermani, së bashku me vëllain, kur ndërroi jetë nëna ime”, – thotë Pater Happel. “Sigurisht që vëllai mund të vendoste vetë për gjysmën e tij, ndërsa gjysma ime i përkiste urdhrit jezuit, pjesë e të cilit unë jam prej një gjysmë shekulli”, – vazhdon ai.

“Por asokohe unë isha rrugëve duke kërkuar mbështetje për projektin tim për themelimin e një gjimnazi në Prizren.

Ndaj i kërkova eprorit tim që pasurinë e trashëguar nga familja t’ia kaloja gjimnazit Loyola.
Ai e miratoi dhe kështu edhe unë u bëra njëfarë donatori modest ndër shumë e shumë të tjerë që kontribuan për ngritjen e gjimnazit”, – thotë Pater Happel, i cili duket sikur pendohet për këtë detaj që më rrëfeu dhe nxiton të ndërrojë temë.

1

Ndërsa ai pendohet, unë habitem. Habitem, pasi gjatë viteve të shumta të njohjes, ai më ka folur me plot respekt për donatorët e shumtë që e kanë mbështetur përpjekjen e tij për të ngritur një institucion të rrallë të dijes në Kosovën e sapodalë nga tmerret e luftës, por asnjëherë për pjesën e tij.

Dhe sot duket sikur ai nuk ndihet mirë që, kureshtjes sime për të kuptuar më thellë origjinën e pronave të shumta të kishës, iu përgjigj me një shembull konkret nga jeta e tij.

Megjithatë, është pikërisht ky episod i vogël, që ai nxiton të harrojë, që mua më mbetet në mendje. Më duket sikur ndër veshë më oshëtijnë thirrjet e denatyruara të shumë shqiptarëve që grinden për të marrë pronat e tyre dhe të të tjerëve, për të marrë, për të marrë, vetëm për të marrë… A thua kemi diçka për të mësuar nga ky episod i thjeshtë që Pater Happel e përmendi pa dashje?

Gjimnazi Loyola është pa dyshim njëri ndër institucionet më të rëndësishme të arsimit në Kosovë, një shkollë që rrezaton kudo ku mbërrijnë nxënësit e saj, në Kosovë e jashtë saj. Loyola është një pasqyrë e mirë ku të gjitha shkollat shqiptare mund të shihen një herë për të parë se si janë. Jo vetëm hapësirat, infrastruktura apo programet, por më së pari nxënësit e tij janë shprehja e një institucioni të mirëfilltë dijeje dhe edukimi. Kur për herë të parë e pata vizituar këtë gjimnaz në vitin 2010, në një ditë të dyerve të hapura, pata mbetur i mahnitur nga performanca e nxënësve të tij.

Atë ditë ata prezantonin shkollën e tyre. Pater Happel, që ishte themeluesi dhe drejtori i gjimnazit, mësuesit dhe stafi tjetër i shkollës ishin thjesht vizitorë, ndërsa nxënësit, plot pavarësi dhe kompetencë, tregonin se çfarë dinin. Disa kryenin eksperimente kimie apo fizike, të tjerë flisnin latinisht, dy skuadra futbolli vajzash luanin në fushën e madhe të blertë, në amfiteatrin e shkollës të tjerë nxënës vinin në skenë Kopracin e Molierit, në një skenë tjetër një grup shpërthyes rroku me vajza dhe djem elektrizonin atmosferën me energjinë e tyre, e diku më tej një tjetër grup i veshur me kostumet e bukura të Kosovës vallëzonte plot hijeshi nën tingujt e këngëve popullore.

Edhe sot, pas më shumë se pesëmbëdhjetë vjetësh, i kam para sysh ato skena të mrekullueshme të një rinie të shëndetshme dhe të edukuar mirë. Kur Pater Happel më pyeti se çfarë mendoja për shkollën asokohe, unë i pata thënë se kjo është vetëm gjysma e një mrekullie. Për t’u plotësuar ajo, do të duhej që gjysma tjetër të ndërtohej në Tiranë.

Megjithë gatishmërinë e tij dhe të miqve të tij të shumtë për të ngritur një shkollë të këtij niveli dhe profili si Loyola e Prizrenit edhe në Tiranë, deri tani ka rezultuar se kushtet për këtë ende nuk janë pjekur ndër ne. Ethet ende të pashuara vetëm për të marrë, por pa dhënë, duket se e bëjnë të vështirë udhën e Loyolës për në Tiranë, edhe pse ajo që kërkohet nuk janë paratë, por vetëm trualli i përshtatshëm e vullneti pa fjalë.

Por po kthehem përsëri tek Pater Happel. Ai sot është në një moshë të madhe, të cilën megjithatë nuk mund ta shquash kur je me të. Gjermania i ka dhënë urdhrin më të lartë që ky shtet jep për qytetarët që kanë merita të veçanta. Nderime i ka bërë edhe Kosova. Njëzet vjet të jetës së tij ai i ka lënë në qendra të dijes: ndër to dhjetë si drejtor në Kolegjin Sankt Blasien në Gjermani dhe dhjetë në Gjimnazin Loyola në Prizren, për të cilat duket se fjalët për të treguar ua ka lënë nxënësve të tij të shumtë e për vete ka mbajtur heshtjen.

Edhe kur ngjitet në Alpet e Tirolit të Jugut, më shumë preferon të reflektojë në heshtje, këtu ku duket se është më afër Zotit të tij, të cilit i ka shërbyer pa bujë për një jetë të tërë. Teksa rrijmë në muzgun e mbrëmjes në ballkon, nga larg vijnë tingujt e orkestrës frymore të fshatit që bën prova për procesionin e nesërm me rastin e ditës së Shën Marisë.

“Në përgjithësi, unë nuk përzihem shumë në përgatitjet për nesër”, – më thotë, – “njerëzit e dinë vetë se çfarë duhet të bëjnë.”

Dhe e nesërmja nuk vonon. Kisha e vogël në qendër të fshatit nuk ka më vend, ndaj shumica qëndrojnë jashtë saj. Pas meshës vijon procesioni i gjatë. Vetëm treqind banorë ka i gjithë fshati, por orkestra ka më shumë se dyzet muzikantë. Pastaj kori, zjarrfikësit, shoqatat e gjuetarëve, fëmijët, bartësit e shenjtorëve, banorë të tjerë të hijeshuar me kostumet e tyre kombëtare…

Sa i madh duket sot ky fshat i vogël ndër Alpe. Ndërsa Pater Happel vijon udhën i zhytur në vetvete, a thua se nuk e sheh procesionin, të cilin duket sikur e drejton në mënyrë të mrekullueshme një tjetër dorë e padukshme.

Pas procesionit është festa. Aty pamja ndryshon plotësisht. Banorët këtu marrin role të tjera. Drejtuesi i orkestrës tashmë ka veshur përparësen e kamarierit, të tjerë gatuajnë, të tjerë shërbejnë. Shërbejnë edhe fëmijët e vegjël bashkë me prindërit. Muzikën tashmë e bëjnë muzikantë të një fshati fqinj që kanë ardhur për ndihmë, pasi vendasit shërbejnë.

Të gjithë njerëzit janë në një rol. Një mësues më thotë se turni i tij si pjatalarës fillon nga darka dhe vazhdon deri pas mesnate, kur do të zëvendësohet nga i biri që merr turnin e radhës. Kështu, me turne, vazhdon angazhimi në të gjitha frontet i të gjithëve, edhe pas festës, edhe ditën tjetër, deri kur gjithçka të shkojë në vendin e vet. Të gjithë janë vullnetarë.

Të gjithë blejnë ushqimet që kanë përgatitur vetë dhe paratë shkojnë në favor të shoqatave të fshatit, ku ata vetë janë anëtarë. Dhe të gjithë janë të lumtur e krenarë për atë që arrijnë të bëjnë krejtësisht vetë dhe për vete.

Dje u ndava nga Pater Happel. E lashë atje ndër Alpe, teksa lutet, mediton dhe reflekton, aty më afër Zotit.

U largova i mbushur me përshtypje të rralla, por edhe me njëfarë brenge e borxhi, të një borxhi që mua më duket se ne i kemi këtij njeriu, prej të cilit, vetëm pas pesëmbëdhjetë vjetësh njohjeje, krejt rastësisht, mora vesh që edhe shtëpinë që ka trashëguar nga e ëma e ka dhuruar në heshtje për një shkollë shqipe në Kosovë.

Tiroli i Jugut, 17 gusht 2026

LUMI IBËR I KTHYER SI ARMË KUNDËR SHQIPTARËVE PREJ VËLLAIT SERB TË LIDERIT GLOBAL

NDRIÇIM KULLA

Presidenti serb nuk e paraqiti idenë e ndryshimit të rrjedhës së lumit Ibër në një tryezë teknike për administrimin e ujërave, as si një projekt inxhinierik të shkëputur nga politika, por në një klimë të tensionuar me Kosovën dhe në një gjuhë që e lidhte drejtpërdrejt me sjelljen e shqiptarëve dhe me atë që Beogradi e konsideron si politikë të Prishtinës ndaj serbëve të Kosovës. Sipas raportimeve të fundit, Vuçiç ka deklaruar se Serbia po shqyrton mundësinë e ndërhyrjes në rrjedhën e Ibrit dhe ka përmendur edhe angazhimin e ekspertëve e inxhinierëve.

Këtu fillon një problem i vërtetë. Sepse Ibri nuk është thjesht një vijë blu mbi hartë, nuk është vetëm një lumë që rrjedh nga veriu drejt jugut dhe nuk është një çështje që mund të trajtohet me të njëjtin fjalor me të cilin trajtohet një rrugë, një urë apo një objekt administrativ.

Në një hapësirë ku uji, energjia, bujqësia dhe jeta e qyteteve janë të lidhura me sistemin ujor të Ibrit, ndërhyrja e qëllimshme në rrjedhën e tij mund të prodhojë pasoja që shkojnë shumë më larg se vetë akti teknik.

Dhe kur një ndërhyrje e tillë artikulohet në kontekstin e një konflikti kombëtar dhe territorial, ajo fiton një domethënie politike që nuk mund të fshihet pas fjalës "projekt".

Kjo është arsyeja pse deklarata e Vuçiçit nuk duhet lexuar vetëm në dritën e fjalëve të përdorura, por edhe në dritën e asaj që mund të prodhonte një veprim i tillë nëse do të realizohej. Nëse një shtet kërcënon të përdorë kontrollin mbi një burim natyror jetik për t'i imponuar një popullsie tjetër një sjellje politike, atëherë nuk kemi më të bëjmë vetëm me një mosmarrëveshje territoriale.

Kemi të bëjmë me një mekanizëm presioni mbi kushtet e jetesës deri në kufirin e gjenocidit.

Lumi i Ibrit është një nga arteriet ujore të rëndësishme të Kosovës dhe sistemi i lidhur me të ka rëndësi për furnizimin me ujë dhe energji.

Prandaj, një ndërhyrje e qëllimshme në rrjedhën e tij nuk mund të reduktohet në pyetjen nëse Serbia teknikisht mund ta bëjë apo jo. Pyetja e vërtetë është çfarë ndodh kur një shtet e përdor kontrollin mbi një burim natyror si instrument presioni ndaj një popullsie që jeton përtej kufirit të tij?
Kjo pyetje është më e madhe se Vuçiçi. Ajo lidhet me një nga problemet më të mëdha të shekullit XXI: përdorimin e burimeve natyrore si armë politike. Bota moderne e ka kuptuar prej kohësh se nafta mund të përdoret si instrument presioni, gazi mund të përdoret si instrument presioni, ushqimi mund të përdoret si instrument presioni dhe infrastruktura energjetike mund të përdoret si instrument presioni.

Por uji ka një karakter tjetër, sepse nuk është thjesht mall ekonomik. Është kusht themelor i jetës.

Nëse një ndërhyrje do të kishte si qëllim t'i mohonte një popullsie civile kushtet minimale të jetesës, atëherë nuk do të mund të fshihej më pas formulimit të një "projekti hidroteknik".

Këtu shfaqet një kontradiktë shumë e madhe e politikës së Beogradit. Serbia pretendon se Kosova është pjesë e Serbisë, ndërsa në të njëjtën kohë politika serbe e trajton popullsinë shqiptare të Kosovës si një palë të jashtme ndaj së cilës mund të ushtrohet presion. Por nëse Kosova është, sipas pretendimit të Beogradit, pjesë e territorit të Serbisë, atëherë si mund të justifikohet ndëshkimi i popullsisë së saj për shkak të vendimeve politike të institucioneve të Kosovës? Dhe nëse nuk është pjesë e administrimit real të Serbisë, atëherë çdo ndërhyrje mbi një burim që ndikon drejtpërdrejt në jetën e popullsisë së Kosovës bëhet një çështje e pastër e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Në vitin 1999, problemi i Kosovës u bë një nga krizat më të mëdha të sigurisë në Europë pas Luftës së Ftohtë dhe ndërhyrja ndërkombëtare erdhi pas një periudhe në të cilën represioni, dhuna dhe dëbimet kishin marrë përmasa të mëdha. Pas gjithë kësaj historie, Europa nuk mund të sillet sikur Kosova është një faqe bosh ku gjithçka fillon nga deklarata e radhës së një politikani.

Dhe ka një përgjegjësi ndërkombëtare për të mos lejuar që konfliktet e pazgjidhura të kthehen gradualisht në forma të reja presioni.
Një nga karakteristikat e politikës së Vuçiçit është se deklaratat e tij shpesh lëvizin në kufirin ndërmjet kërcënimit dhe mohimit të kërcënimit. Thuhet diçka e fortë, pastaj lihet hapësira për ta interpretuar ndryshe. Kur kundërshtari reagon, thuhet se ka keqkuptuar. Kur ndërkombëtarët shqetësohen, thuhet se bëhet fjalë për një çështje teknike. Kur publiku kërkon sqarim, mund të thuhet se nuk ka pasur kërcënim. Por fjala ka bërë tashmë punën e saj.

Kjo është strategjia moderne e paqartësisë së kontrolluar e vëllait serb të Ramës, Vuçiç: një kërcënim i qartë mund të dënohet qartë, ndërsa një deklaratë e paqartë krijon frikë dhe njëkohësisht i jep autorit mundësinë të tërhiqet. Në këtë kuptim, çdo deklaratë që lidh ndryshimin e rrjedhës së Ibrit me sjelljen e shqiptarëve duhet parë edhe si një sinjal politik.

Dhe sinjalet në Ballkan kanë pasur historikisht pasoja.

Prandaj problemi nuk është vetëm nëse Serbia ka sot kapacitetin teknik për ta ndryshuar rrjedhën e Ibrit në mënyrën që sugjerohet. Problemi është pse një president shteti e vendos një mundësi të tillë në tryezën politike dhe pse e lidh atë me sjelljen e një popullsie tjetër. Kjo është pyetja që duhet të bëjë Europa tani.
Çështja e Ibrit mund të jetë shumë më e rëndësishme sesa vetë lumi. Ajo mund të jetë një provë, një provë për të parë se deri ku mund të shkojë politika e presionit mbi Kosovën. Sepse historia e konflikteve territoriale na mëson se pas një kërkese për ndryshim kufijsh mund të vijë kërkesa për autonomi, pastaj kërkesa për territore, pastaj kontrolli mbi infrastrukturën, pastaj kontrolli mbi burimet dhe, në fund, krijimi i një sistemi varësie ku një popullsi e tërë kupton se jeta e saj mund të ndikohet nga vendimet e një shteti tjetër.

Kjo është arsyeja pse ideja e ndryshimit të rrjedhës së Ibrit nuk duhet të trajtohet si një episod ekzotik i politikës serbe. Është pjesë e një historie më të gjerë mbi kontrollin. Dhe kontrolli i burimeve është një nga format më të rëndësishme të pushtetit në shekullin tonë.
Ibri ka qenë gjithmonë më shumë se një lumë. Ai ka kaluar përmes një territori ku historia ka vendosur kufij, ku kufijtë kanë ndryshuar histori dhe ku historia ka prodhuar konflikte të reja. Por një lumë nuk duhet të bëhet instrument i hakmarrjes. Nuk duhet të bëhet armë. Nuk duhet të bëhet mënyrë për t'i treguar një populli se jeta e tij varet nga vullneti i një shteti tjetër.

Sepse nëse politika arrin deri aty sa të thotë: "Nëse nuk bëni atë që kërkojmë, do t'ju presim fytin", atëherë nuk kemi më të bëjmë vetëm me një mosmarrëveshje territoriale.
Kemi të bëjmë me një filozofi terrori.

Prandaj deklarata e Vuçiçit duhet të merret seriozisht jo sepse duhet të shpallet menjëherë "gjenocid", por sepse një shtet europian i shekullit XXI nuk mund ta vendosë në tryezën politike idenë e përdorimit të një burimi jetik si mjet hakmarrjeje ndaj një popullsie dhe të presë që bota ta trajtojë këtë si një çështje teknike.

Nuk është vetëm çështja se ku do të rrjedhë Ibri.
Është çështja se ku po shkon politika që dëshiron ta ndryshojë rrjedhën e tij.

Dhe Europa nuk duhet të presë që lumi të thahet për të kuptuar se çfarë kishte filluar të ndodhte.
Dhe pikërisht aty, në atë çast kur uji nuk shihet më si pasuri e natyrës, por si mjet ndëshkimi ndaj një popullsie, duhet të ndizet alarmi i historisë, i politikës dhe i së drejtës ndërkombëtare, shumë përpara se bota të detyrohet të kërkojë një emër për një tragjedi që mund të ishte parandaluar.

PËRGJIGJE AMBASADORIT NEBOJSHA VUJOVIQ: NJË SERBI QË ËSHTË NË PAQE ME VETE E ME FQINJËT

VETON SURROI

Fërkimin e tanishëm në rrugët e Serbisë e shoh si fërkim mes konceptit të kontinuitetit dhe të tranzicionit. Në mungesë të arritjes së një konsensusi mes pushtetit dhe revoltës qytetare duket sikur do të ketë gjithnjë më shumë njerëz në rrugë dhe besim të tyre se rruga në fund do ta zgjidhë fatin e politikës në Serbi.

1.

Të sqaroj që në fillim, zotëri ambasador, një keqkuptim tuajin, i cili është një lloj premise e përgjithshme e një pjese të konsiderueshme të mendimit politik të vendit tuaj të mbajtur për një kohë të gjatë, mbi një shekull. Përpjekja për pavarësi të Kosovës dhe arritja e pavarësisë së Kosovës nuk janë bërë për të dëmtuar popullin serb, por për të mbrojtur interesin e qytetarëve të Kosovës, në fund për ta mbrojtur edhe ekzistencën fizike të tyre. Lëvizja për pavarësi ka qenë e ndërtuar po ashtu si lëvizje për demokraci e integrim në botën euroatlantike dhe ne që kemi marrë pjesë në të, si zëra më të artikuluar prej shembjes së Murit të Berlinit e deri më sot, kemi vënë në spikamë se duam të jetojmë në paqe e bashkëpunim me popujt e tjerë. Adem Demaçi, të cilin e përmendni, e i cili është demonizuar përgjatë dhjetëvjetëshve në qarqet nacionaliste serbe, në deklaratat e para pas daljes nga viti i 26-të i burgimit është shprehur se nuk ekziston armiqësi e nuk duhet të ekzistojë armiqësi me popullin serb. Pjesë e rëndësishme e qëndrimit tonë ndaj komuniteteve joshumicë në vendin tonë shihet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, njërit prej dokumenteve më të avancuara juridike për mbrojtjen e pakicave në Evropë.

Keqkuptimi i parë në premisë çon te keqkuptimi i dytë, ai se veprimet tona në Kosovë janë të drejtuara drejt dëmtimit të Serbisë, një lloj ekuacioni që thotë se sa më keq të jenë gjërat në Serbi, aq më mirë për Kosovën. Po jua ndihmoj heqjen edhe të këtij keqkuptimi: unë besoj se interesi strategjik i Kosovës është një Serbi demokratike, e avancuar, evropiane; një Serbi që është në paqe me veten e me ne të tjerët, shtetet fqinje.

Kjo nuk është vetëm shprehje e empatisë njerëzore, por edhe mësim i ndërtuar nga përvoja jetësore. Serbia jodemokratike e në delirium nacionalizmi u ka sjellë vite të vështira popujve fqinjë gjatë shekullit XX. Në Kosovë këtë e përjetuam pothuajse gjatë tërë shekullit XX dhe vazhdimin e luftërave të papërfunduara me forma të tjera në shekullin XXI, përfshirë përpjekjen për kryengritje të armatosur në Banjskë më 2023.

Pra, shikuar kështu, është në interesin tonë në Kosovë që shteti juaj të jetë ndryshe prej ç'është e ç'ka qenë, që të jetë demokratik.

2.

Në shkrimin tim të mëparshëm tërhoqa dy vërejtje që mendoj se janë sfida në rrugën për demokraci.

E para është ligjërimi i luftërave të papërfunduara të ish-Jugosllavisë. Të rinjtë e sotëm në Serbi janë rritur në një ambient toksik ku vendin parësor të ligjërimit nuk e zënë vlerat evropiane, por vazhdimi i luftërave të papërfunduara me mjete të tjera - në Bosnjë e Hercegovinë, Kosovë, Kroaci e së fundmi edhe Mal të Zi. Ky është pak a shumë ligjërim tashmë konsensual në shoqërinë tuaj me një pakicë të spikatur dhe të dinjitetshme e të distancuar, që gjithnjë ka mbajtur si parësor interesin e Serbisë evropiane.

Sfida e dytë është polarizimi i skajshëm i shoqërisë që po ashtu përdor gjuhën e luftërave të papërfunduara (si p.sh. "ustashë"), një gjuhë që është parapërgatitje arsyetimi për përdorimin e dhunës në nivel më të lartë se deri më tani.

Këto sfida po jetojnë në një kontekst në të cilin është duke munguar identifikimi i konceptit parësor të zgjidhjes së krizës politike në vend, pra a do të mund të zgjidhet kjo krizë me mjetet e rëndomta (të lodhjes së protestuesve, zgjedhje parlamentare duke u mbështetur në precedentët e së kaluarës) apo ka nevojë për instrumente të tranzicionit sistemor, prej autokracisë në demokraci parlamentare.

Fërkimin e tanishëm në rrugët e Serbisë e shoh si fërkim mes konceptit të kontinuitetit dhe atij të tranzicionit. Në mungesë të arritjes së një konsensusi mes pushtetit dhe revoltës qytetare, duket sikur do të ketë gjithnjë më shumë njerëz në rrugë dhe besim të tyre se rruga në fund do të zgjidhë fatin e politikës në Serbi.

Po e përsëris pra edhe një herë atë që shkrova në shkrimin e mëparshëm. Serbia nuk ka dashur apo nuk ka ditur si të ballafaqohet me të kaluarën e luftërave të ish-Jugosllavisë, sot nuk po di si të ballafaqohet me të tashmen.

Do të dëshiroja që shteti juaj të gjejë rrugën demokratike të ballafaqimit me të tashmen dhe që kjo rrugë të shpjerë te Serbia demokratike, evropiane. Por, sado që kjo të jetë në interes të Kosovës dhe të fqinjëve të tjerë, këtë nuk besoj se mund, e as që duhet ta bëjë dikush tjetër pos qytetarëve të Serbisë.

3.

Kam parë te lëvizja studentore në Serbi - te kreativiteti i saj, forca e protestës së padhunshme - ato që i kishim në Kosovë me lëvizjen paqësore më 1989 e 1990 në Kosovë. Di mirë se si ndihen studentët, kam qenë njëri prej organizatorëve në atë kohë e në kushte shumë më të vështira, kur policia përdorte armë zjarri.

Analogjitë zakonisht çalojnë dhe kjo është e vërtetë edhe në këtë rast. Por më duket me rëndësi të nxjerr dy mësime. I pari është se sado kreativ të jesh si protestues i padhunshëm, pushteti që nuk ka kufizim ligjor a moral do të përdorë gjithnjë e më shumë dhunë. I dyti është se protesta është akt çlirimi prej frike dhe kjo është me rëndësi për një popull të shtypur a frikësuar, por kjo jo domosdoshmërisht do të thotë se ai popull e ka gjetur lirinë; liria do institucione që e sigurojnë, që e mbrojnë, që e zhvillojnë.

Mendoj se revolta qytetare në Serbi gjendet përballë këtyre dy mësimeve. Dhe nuk janë mësime kosovare; më herët me to u ballafaquan polakët e lëvizjes Solidarnoshç.

Në fakt, e me mundësi të madhe gabimi ngase po i vështroj zhvillimet në vendin tuaj nga larg, ndonjëherë më duket sikur kriza që po kalon vendi juaj është ajo e rrëzimit të Murit të Berlinit, 30 e kusur vjet më vonë. Për rininë që ka dhjetë muaj që del në rrugë kjo është një barrë edhe më e madhe, të kërkesave për diçka që duhej të ishte zgjidhur nga prindërit e tyre shumë më herët; një rini e rritur me rrëfime të luftërave që nuk po përfundojnë.

4.

Nuk di çfarë do të jenë zhvillimet në vendin tuaj, por di një gjë, demokracia nuk është e pashmangshme. Pra, fakti se ka pasur dhe do të ketë protesta, fakti se tashmë mbi gjysma e qytetarëve përkrahin lëvizjen studentore nuk do të thotë se fundi i kësaj krize do të prodhojë një Serbi demokratike. Gravitacioni autoritar (i ndërlidhur me nacionalizëm) është tradicionalisht më i fortë dhe nuk do elaborim të madh teorik për këtë, mjafton të shikohet se si e filloi Serbia këtë shekull (në tetor 2000) e ku ka arritur tani.

Pranoni urimet më të mira për ju dhe vendin tuaj. Shpresoj që Serbia më në fund të ballafaqohet me të tashmen e të dalë me paqe e konsensus demokratik për një shtet që do të jetë fqinji ynë evropian.

SHQIPTARË NË BRITANI

Dotech websites

BIZNESI JUAJ MERITON NJË WEBSITE QË SJELL REZULTATTE

A keni një biznes në MB por ende nuk keni një **faqe interneti profesionale?**

Dotech Websites ju ndihmon të krijoni një faqe moderne që sjell më shumë klientë dhe rrit besueshmërinë e biznesit tuaj.

- Website profesional dhe modern
- I përshtatur për telefon, tablet dhe kompjuter
- Optimizim për Google (SEO)
- Shpejtësi dhe siguri maksimale
- Dyqan online (E-commerce)
- Email profesional me emrin e biznesit tuaj
- Mbështetje teknike në gjuhën shqipe

NA KONTAKTONI SOT PËR NJË KONSULTIM FALAS!

020 7018 7929

Whatsup: 073 4066 5946

Whatsup: 078 5997 7545

ADRESA E ZYRAVE:
30 Avenons Road,
London, E13 8HT

WEBSITE
www.dotech.uk

EMAIL
info@dotech.uk

DOTECH WEBSITES
Website profesionale për bizneset shqiptare në Britani.

REL

PËRFAQËSUESIT POLITIKË TË LUGINËS BISEDOJNË ME KRYEDIPLOMATIN SHQIPTAR PËR KONSULLATËN NË BUJANOC

Përfaqësuesit politikë të shqiptarëve në Serbi e kanë vlerësuar me rëndësi të madhe politike praninë konkrete institucionale të Shqipërisë në Luginë të Preshevës, përmes hapjes së një konsullate në Bujanoc.

Për këtë çështje u diskutua gjatë një takimi në Tiranë mes kryediplomatit shqiptar, Ferit Hoxha, dhe deputetit shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, kryetares së Preshevës, Ardita Sinani, kryetarit Bujanocit, Arbër Pajaziti dhe udhëheqësit të Këshillit Kombëtar Shqiptar, Enkel Rexhepi.

Ministri Hoxha tha se biseda ishte përmbajtësore dhe u përqendrua në çështjet që kërkojnë bashkërendim: "mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve, ruajtjen e identitetit dhe forcimin e përfaqësimit të tyre me fuqi reale në jetën politike dhe institucionale të Serbisë, si dhe adresimin e nevojave konkrete të qytetarëve të Luginës".

Deputeti i vetëm shqiptar në Kuvendin serb, Shaip Kamberi, tha se vlerëson angazhimin e Shqipërisë për mbështetjen e shqiptarëve në Luginë të Preshevës – term që përdoret për komunat Preshevë, Medvegjë e Bujanoc në jug të Serbisë ku jetojnë shqiptarët.

"Hapja e Konsullatës së Shqipërisë në Bujanoc është një hap me rëndësi të veçantë politike dhe simbolike. Prania institucionale e Shqipërisë në Luginë është një dëshmi e vëmendjes së drejtpërdrejtë ndaj shqiptarëve dhe një mundësi për ta bërë edhe më të fortë lidhjen institucionale me Shqipërinë", shkroi ai në rrjetet sociale.

Shqipëria dhe Serbia po diskutojnë për hapjen e dy zyrave konsullore, një shqiptare në Bujanoc, dhe një serbe në Shkodër. Ministri Hoxha ka thënë më herët se Shqipëria synon që më në fund të ketë një prani konsullore të përhershme në jug të Serbisë.

Kryetarja e Komunës së Preshevës, Ardita Sinani, tha se vazhdimisht përfaqësuesit politikë të Luginës së Preshevës kanë kërkuar rritjen e pranisë institucionale të Shqipërisë dhe Kosovës.

"Hapja e Konsullatës së Republikës së Shqipërisë në Bujanoc do të ishte shumë më tepër sesa hapja e një përfaqësie diplomatike. Do të ishte një prani konkrete e shtetit shqiptar pranë shqiptarëve të Luginës dhe një urë institucionale edhe më e afërt me ta", tha ajo.

Sinani falënderoi Kosovën për mbështetjen që i ofron shqiptarëve të Luginës së Preshevës, por ajo theksoi se fondet që vijnë nga Kosova, hasin në pengesa të Serbisë. Pengesa të ngjashme, sipas saj, ka edhe për për mbështetje financiare nga Shqipëria, prandaj, sipas Sinanit, bëhet edhe më e rëndësishme që të dy shtetet të kenë një prani më të afërt institucionale në Luginë.

"Afrimi i përfaqësive institucionale në Luginën e Preshevës do të kishte një rëndësi të madhe për popullatën shqiptare këtu. Do të lehtësonte komunikimin e drejtpërdrejtë, adresimin e çështjeve me interes për qytetarët dhe lidhjen institucionale me Tiranën dhe Prishtinën", tha Sinani.

Ndërkaq, udhëheqësi i Bujanocit, ku po diskutohet që të hapet Konsullata, tha se komuna që drejton është "plotësisht e gatshme" të përmbushë çdo obligim që është në kompetencë të saj, që ky proces të finalizohet sa më shpejt.

Sipas kryetarit të Këshillit Kombëtar Shqiptar, Enkel Rexhepi, Konsullata shqiptare në Bujanoc do të shpërbente si institucion për bashkërendimin e politikave.

"Më shumë Shqipëri dhe Kosovë në Luginë", shkroi ai në rrjetet sociale.

Në Serbi jetojnë më shumë se 60.000 shqiptarë, të cilët përbëjnë pakicën e katërt më të madhe në këtë shtet, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të realizuar në vitin 2022.

Kosova, Shqipëria, por edhe Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian e kanë kritikuar Serbinë lidhur me të drejtat e shqiptarëve.

Më herët gjatë këtij viti, Komiteti për Politikë të Jashtme i Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit amerikan miratoi një projektligj, që i kërkonte sekretarit amerikan të Shtetit të përgatiste një raport gjithëpërfshirës për pozitën e pakicave në Serbi, me fokus të veçantë te shqiptarët në Luginën e Preshevës.

Po në maj të këtij viti, një delegacion i kongresistëve amerikanë vizitoi Luginën e Preshevës, dhe në mesin e kongresistëve ishte edhe Keith Self nga radhët e republikanëve, nismëtar i projektligjit.

"Kemi parë se ka probleme reale mes shqiptarëve dhe Serbisë, siç edhe e kemi ditur", u tha Self gazetarëve pas vizitës në Preshevë.

Projektligji i miratuar në Komitetin për Politikë të Jashtme parashikon shqyrtimin e disa çështjeve që lidhen me pakicën shqiptare në Serbi, përfshirë pasivizimin e adresave, përkatësisht fshirjen e qytetarëve nga adresat ku janë të regjistruar.

Pasivizimi i adresave nënkupton fshirjen e qytetarëve nga adresat ku kanë qenë të regjistruar. Ky veprim rezulton me humbjen e shtetësisë serbe dhe, rrjedhimisht, të drejtave civile, përfshirë të drejtën për të votuar, për të pasur pronë, për të përfituar sigurim shëndetësor e pension, si dhe për t'u punësuar.

Çështja është ngritur vazhdimisht nga shqiptarët në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, si dhe nga Qeveria e Kosovës, e cila e ka cilësuar praktikën si diskriminuese.

Në Raportin e Progresit për Serbinë të publikuar në fund të vitit të kaluar nga Komisioni Evropian, në pjesën për mbrojtjen e minoriteteve thuhet se "pjesëtarët e minoritetit kombëtar shqiptar vazhdojnë të ngrenë shqetësime lidhur me mënyrën se si policia kontrollon statusin e banimit të tyre në jug të Serbisë, duke rezultuar me 'pasivizimin' e adresave të caktuara".

Çështja e pasivizimit është përmendur edhe në raportin e Departamentit amerikan të Shtetit për të drejtat e njeriut në Serbi për vitin 2023, ku thuhet se kjo praktikë duket se është zbatuar në mënyrë joproporcionale ndaj shqiptarëve, sidomos në Medvegjë

(Radio Evropa e Lirë)

190 Merton High Street
Wimbledon
London SW19 1AX

RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

Ne mund t'ju ndihmojmë

- Asylum & Immigration
- New Point Based System
- Settlement Applications (ILR)
- European Law
- Nationality&Travel Document
- Human Rights Applications
- High/Court of Appeals
- Over Stayers
- Work Premits
- Visa Extensions
- Judicial Reviews
- Tribunal Appeals

Konsultimet falas

07774222062
07878335000
TEL: 0208 5401 666
TEL: 0208 672 0666